



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TE BIMËVE

KATALOGU I VARIETETEVE TË FERMERIT

Tiranë, 2018

KATALOGU I VARIETETEVE TË FERMERIT

Botim i Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve

Materialet dhe fotot u punuan:

Prof. Dr. Sokrat JANI: Bimët perimore

Dr. Valbona HOBDAI dhe Prof. As. Dr. Belul GIXHARI: Bishtajoret

Prof. Dr. Fetah ELEZI: Drithërat

Prof. Dr. Fetah ELEZI: Misri

Prof. As. Dr. Frida ÇARKA: Hardhia

Dr. Rajmonda SEVO dhe Prof. As. Dr. Frida ÇARKA: Molla dhe Kumbulla

Prof. As. Dr. Frida ÇARKA dhe Dr. Ilir Çiçi: Dardha

Prof. As. Dr. Tatjana KOKAJ: Pemët subtropikale

Dr. Hairi ISMAILI dhe Prof. As. Dr. Adriatik ÇAKALLI: Ulliri

Dr. Dorian (Bode) XHULAJ: Bimët Mjekësore dhe Aromatike

Koordinator i përgatitjes së materialeve: **Prof. Dr. Sokrat JANI**

Përgatiti: "Jupiter Group"

Redaktoi: Nevila Zeneli

Tirazhi: 300 kopje

U mundësua me mbështetje të Projektit "Conservation of Agrobiodiversity in Rural Albania – CABRA", të GIZ - Albania

I nderuar lexues,



Me anë të këtij Katalogu ju mund të njiheni me varietetet kryesore autoktone apo tradicionale të specieve që kultivohen në Shqipëri për bujqësinë dhe ushqimin si dhe me një informacion të shkurtër për kultivimin e tyre.

Botimi i Katalogut bëhet në kuadër të përpjekjeve që po bëhen për njohjen, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve gjenetike të bimëve me vlerë të veçantë për bujqësinë dhe ushqimin ose të rrezikuara nga erozioni gjenetik.

Përgatitja për botim e Katalogut të Varieteteve Tradicionale të Shqipërisë është fryt i punës me përkushtim të stafit të Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGJB), në Universitetin Bujqësor të Tiranës të cilët i falënderoj për kontributin e tyre.

Bazuar në studimet e kërkuesve vendas e të huaj, Shqipëria konsiderohet një vend i pasur me resurse gjenetike bimore si dhe është vend origjinë për disa specie e varietete të kultivuara. Prania e ullinjve mijëra vjeçar në disa zona të vendit e vërteton më së miri.

IRGJB ruan dhe administron Inventarin Kombëtar të Resurseve Gjenetike të Bimëve në formën e farës në Bankën Gjenetike si dhe në Koleksionin Gjenetik Fushor të drufrutorëve në Valias, Tiranë. Një pjesë e resurseve gjenetike të drufrutorëve ruhet në koleksionin e QTTB Vlorë dhe një koleksion i mollës në QTTB Korçë.

Një numër i konsiderueshëm i resurseve gjenetike bimore, të koleksionuara në Shqipëri nga ekspert të huaj në shekullin e kaluar, ndodhen në Bankat Gjenetike të shteteve të ndryshme dhe po bëhen përpjekje për riatdhesimin e tyre.

Inventari Kombëtar i Resurseve Gjenetike të Bimëve është i dokumentuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe i publikuar në rrjetin European të resurseve gjenetike (EURISCO).

Përcaktimi i origjinës së varieteteve ose i futjes së tyre në Shqipëri është bërë mbi bazën e dokumentacionit ekzistues, të publikimeve të bëra nga kërkuesit si dhe të kriterëve ndërkombëtare për emërtimin varietetet “autokton”, “tradicional” ose “varietet i fermerit”. Shumë varietete mbajnë emrat e fshatrave ku janë kul-

tivuar më herët ose për një periudhë më të gjatë. Kultivimi i tyre ose përdorimi i qëndrueshëm, është ruajtja më e mirë dhe e sigurt. Megjithatë, vetëm një numër i kufizuar i varieteteve që aktualisht kultivohen ose ka interes për tu përhapur në prodhim janë përfshirë në këtë Katalog.

Në kuadër të zhvillimit të agroturizmit, veçanërisht në zonat kodrinore e malore, ato mund të kultivohen dhe të prodhohen e të përdoren produkte tipike të zonës.

Shtimi i kujdesit dhe ndërgjegjësimi për përdorimin e varieteteve tradicionale nga komuniteti i zonës dhe i mbështetjes nga organet lokale e qendrore, nga donatorët, akademikët dhe media, do të mundësojë rritjen e të ardhurave në ato zona si dhe do të shtohen resurset gjenetike të vendit.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është angazhuar për zbatimin e programit për shtimin farës së disa varieteteve më të kërkuara si dhe restaurimin e disa varieteteve tjera mbi bazën e metodikave shkencore.

Ne besojmë se katalogu do të ndihmojë në shtimin e informacionit për fermerët, specialistët e bujqësië e të agrobiznesit, kërkuesit, donatorët, etj. për realizimin misionit dhe të objektivave në këtë fushë shumë të rëndësishme të ekonomisë por edhe të historisë dhe kulturës sonë.

IRGJB do ju jetë mirënjohës të gjithë atyre që do të kontribuojnë për pasurimin e katalogut me varietete të tjera tradicionale me vlerë për përdorimin e tyre të qëndrueshëm.

Prof. Dr. Fetah Elezi

Drejtor i Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve

Dear reader,



Through this catalog you can get acquainted with the main autochthonous or traditional varieties of species cultivated in Albania for agriculture and food. The publication of the Catalog is done in the framework of the efforts being made for the recognition, preservation and sustainable use of plant genetic resources of particular value for agriculture and food or endangered by genetic erosion. The preparation for publication of the Catalog of Traditional Varieties of Albania is the result of the dedicated work of the Institute of Plant Genetic Resources (IPGR) staff at the Agricultural University of Tirana, who I thank for their contribution.

Based on the studies of domestic and foreign researchers, Albania is considered a country rich in plant genetic resources and a country of origin for some cultivated species and varieties. The presence of thousands of years old olives in some parts of the country confirms this.

The IPGR maintains and administers the National Inventory of Plant Genetic Resources in the form of seeds at the Genetic Bank as well as in the Genetic Field Collection in Valias, Tirana. A part of the genetic resources of fruit trees are preserved in the collection of ATTC Vlora and an apple collection at ATTC Korça.

A considerable number of plant genetic resources, collected in Albania by foreign experts in the last century, are in the Gene Banks of different states and efforts are being made to repatriate them.

The National Inventory of Plant Genetic Resources is documented according to international standards and published in the European Network of Genetic Resources (EURISCO).

Determination of the origin of varieties or their introduction in Albania was made on the basis of the existing documentation, of the publications made by researchers and of the international criteria for the denomination varieties "autochthon", "traditional" or "farmer variety". Many varieties bear the names of the villages where they were cultivated earlier or for a longer period. Cultivation or sustainable use is the best and safest preservation. Therefore, only a limited

number of varieties currently cultivated or having an interest in propagating in production are included in this Catalog.

In the framework of agritourism development, especially in hilly and mountainous areas, they can be cultivate, produce and use typical products of the area.

Increasing the care and awareness for using traditional varieties from the local community and supporting local and central authorities, donors, academics and the media will enable revenue growth in those areas and increase the country's genetic resources.

Agricultural University of Tirana is committed to implementing the program for seedlings of some of the most sought varieties and the restoration of some other varieties on the basis of scientific methods.

We believe that this catalog will help increase the information for farmers, agricultural and agribusiness specialists, researchers, donors, etc. for accomplishing the mission and objectives in this very important field of the economy, but also of our history and culture.

The IPGR will be grateful to all those who will contribute to enriching the catalog with other traditional varieties of value for their sustainable use.

Prof. Dr. Fetah Elezi

Director, Institute of Plant Genetic Resources

Domatja “Serreke” e Përmetit

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e jugut njihet e kultivohet për mbi 80-100 vjet. Fara e saj mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 10-15% të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me ndërrnyje të shkurt-ra dhe masë gjethore të dendur; lulëri e thjeshtë, me 4-6 fruta në lulesë; fruta të rrumbullakët e me pole lehtësisht të shtypur, mesatarisht të mëdha, 200–220 g, ngjyrë e kuqe e plotë, me shije të mirë.

Kultivimi: Domate me cikël mesatarisht të gjatë. Mbillet në fushë nga fundi prillit deri në fund majit. Vjelja e prodhimit fillon pas 8-10 javë, në korrik dhe vazhdon deri në tetor. Në traditën e zonës mbahen me 4-5 lulesa (kate prodhimi) / bimë.

Rendimenti: rreth 35 -40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vru-gut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Në vite të veçanta, në kushte me lagështi ajrore, frutat kanë plasaritje të lehta radi-ale.

Përdorimi:

E freskët për sallata dhe gatime të ndryshme, por edhe për përgatitje të salcave dhe turshive. Preferohet për konsum në familje dhe për treg.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.



Domate "Serreke" e Përmetit

Domatja e Sanjollasit

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Origjinën mendohet se e ka nga Stambolli. Në Shqipërinë jug-lindore, kryesisht në rrethet Kolonjë dhe Korçë, njihet e kultivohet për më se 150 vjet. Fara e saj trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 10% të sipërfaqes së domates në zonë.



Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me masë gjethore të dendur; lulëri e thjeshtë, me 4-6 fruta në lulesë; fruta të rrumbullakët, me ngjyrë të kuqe, tulore, e ëmbël e me shije të veçantë, me peshë mesatare 220 - 250 g.

Kultivimi: Domate me cikël mesatarisht të gjatë. Mbillet në fushë nga fundi prillit deri në fund majit. Vjelja e prodhimit fillon në korrik dhe vazhdon deri në tetor. Në traditën e zonës mbahen me 4 - 5 lulesa ose kate prodhimi / bimë.

Rendimenti: rreth 35 -40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta. Kultivohet në zona të larta, mbi 400 m mbi nivelin e detit. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm;

Negative: Në vite të veçanta, në kushte me lagështi ajrore, frutat kanë plasaritje të lehta radiale.

Përdorimi:

E freskët për sallata dhe gatime të ndryshme, por edhe për përgatitje të salcave dhe turshive. Në disa fshatra përdoret edhe si domate e tharë, për konsum dimëror. Preferohet për konsum në familje dhe për treg.



Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje.

Domatja e Tiranës

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme, kryesisht në zonën e Piskës dhe Shëngjergjit, njihet e kultivohet për më se 100 vjet. Fara e saj është mbajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht, zë më pak se 5% të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Gjendet në dy forma, të regjistruara në inventarin e Bankës Gjenetike të Bimëve si Tirana-92 dhe Tirana-100. Më e preferuar dhe më e përhapur në prodhim është Tirana-92, sepse ka fruta më të mëdha dhe është e përshtatshme për prodhim të mesëm e të vonë.

- Tirana-92, ka bimë të tipit gjysmë të kufizuar, masë gjethore mesatarisht të dendur dhe lulëri të thjeshtë. Zakonisht formon 4-5 lulesa / bimë, por në traditën e zonës mbahet me 3-4 lulesa (ose kate prodhimi). Frutat janë të rrumbullakët e me pole lehtësisht të shtypur, mesatarisht të mëdha, 180 - 200 g, ngjyrë e kuqe e plotë, me shije të mirë. Është mesatarisht e vonë.

- Tirana-100, ka bimë të tipit të pakufizuar, masë gjethore të dendur dhe lulëri të thjeshtë. Zakonisht formon 6-8 lulesa / bimë, por në traditën e zonës mbahet me 4 - 5 lulesa prodhimi. Frutat janë të rrumbullakët e me pole të shtypur, me peshë mesatare 150-160 g, ngjyrë e kuqe. Është mesatarisht e hershme



Kultivimi: Domate Tirana-92, ose domate e vonë e Tiranës, ose e Shëngjergjit. Mbillet në fushë nga fundi muajit Maj e fillimi Qershorit dhe vjelja e prodhimit fillon pas 8-10 javë, në gusht dhe vazhdon deri në tetor.

Domatja “Zemër kau”

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme njihet e kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara e saj mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht, zë rreth 10-15% të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me ndërnyje të shkurtra dhe masë gjithore mesatarisht të dendur; lulëri e thjeshtë, me 3-5 fruta në lulesë. Frutat janë në formë zemre, nga ka marr edhe emrin, me peshë 250–350 g, nuk përjashtohen rastet 600-700 g. Frutat kanë ngjyrë rozë, kurse nga ana e bishtit e ruajnë edhe në pjekje ngjyrën jeshile; ata janë tukur dhe kanë shije të mirë e të veçantë.

Kultivimi: Domate me cikël mesatarisht të gjatë. Mbillet në fushë në gjysmën e parë të prillit, deri në fund të majit. Vjelja e prodhimit fillon pas 10-12 javë, në korrik dhe vazhdon deri në tetor. Në traditën e zonës mbahen me 4-5 lulesa prodhimi/bimë.

Rendimenti: rreth 35 -40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm. Pëlqehet nga konsumatori.

Negative: Në vite të veçanta, me lagështi ajrore, frutat kanë plasaritje të lehta radiale. Nuk i qëndron transporteve të gjata; kërkon ambalazhim të veçantë.

Përdorimi:

E freskët për sallata dhe gatime të ndryshme. Preferohet për konsum në familje dhe lokale.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjarë¹⁰ -



Domatja e Dhoksatit

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e jugut, veçanërisht në zonën e Lunxhërisë (Gjiro-kastër), njihet e kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara mbahet e trashëgohet prej shumë breza nga bahçevanët. Aktualisht, zë rreth 10-15% të sipërfaqes së mbjell me domate në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me masë gjethore të dendur. Ka lulëri të përbërë (me shumë degë). Formon 5-6 fruta për lulesë. Ata janë të mëdha, të rrumbullakët e me pole të shtypur, me brinjëzim të fortë, lëkur të hollë, peshë mesatare 250–300 g, ngjyrë e kuqe e plotë, me aromë të veçantë e shije të mirë.

Kultivimi: Domate me periudhë vegjetacioni mesatarisht të gjatë. Mbillet në fushë nga fundi prillit deri në fund majit dhe vjelja e prodhimit fillon pas 10-12 javë, në fund korrikut dhe vazhdon deri në tetor. Në traditën e zonës mbahen me 4-5 kate prodhimi/bimë.

Rendimenti:

rreth 35 -40 kv/dynym.



Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk i qëndron transporteve të gjata.

Përdorimi:

Përdoret si e freskët për sallata dhe gatime të ndryshme.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.

Domatja “Pistilkë” e Korçës

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës e Pogradecit njihet e kultivohet për më se 80 -100 vjet. Mendohet se është me origjinë nga SHBA-të. Fara është ruajtur nga bahçevanët dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me masë gjethore mesatarisht të dendur, lulëri e thjeshtë, 6-8 lulesa/bimë, me 10-12 fruta në lulesë. Ata janë të vegjël në formë kumbullore, peshë mesatare 35 – 40 g, ngjyrë e kuqe intensive, me shije të veçantë.

Kultivimi:

Domate me cikël të shkurtër dhe pjekje të hershme. Mbillet në 10-15 maj dhe vjelja e prodhimit fillon pas 8-9 javë, në mes të korrikut dhe vazhdon deri në ngjicat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 35 -40 kv/dynym.



Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta.

Negative: Jep prodhim relativisht të ulët, por të qëndrueshëm;

Përdorimi:

Përdoret si e freskët dhe gatime të ndryshme. Preferohet për konsum në familje.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje

Domate kokërr vogël e Shalës

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në zonën e Shalës së Dukagjinit (Shkodër) kultivohet për më se 70-80 vjet; fara mbahet nga familjet duke e trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me ndërrnyje të shkurtra; lulëri e thjeshtë, 7-8 lulesa/bimë, me 10-12 fruta në lulesë; fruta të vegjël me majucë, me peshë mesatare 30-35 g, ngjyrë e kuqe e plotë, me shije të veçantë.

Kultivimi: Domate me cikël të shkurtër. Mbillet në fushë rreth 10-15 maj dhe vjelja e prodhimit fillon pas 8-10 javë, në mes të korrikut dhe vazhdon deri në ngriçat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 15 -25 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

E freskët dhe për gatime të ndryshme. Preferohet për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Rreziku: Është në rrezik zhdukjeje.



Domatja e verdhë e Korçës

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës e Pogradecit njihet e kultivohet për më se 80 -100 vjet. Mendohet se është me origjinë nga SHBA-të. Fara është ruajtur nga bahçevanët dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Bimë e tipit të pakufizuar, me masë gjethore mesatarisht të dendur dhe lulëri të thjeshtë. Zakonisht formon 5-8 lulesa / bimë, por në traditën e zonës mbahet me 3-4 lulesa (ose kate prodhimi). Frutat janë të rrumbullakët, uniforme, mesatarisht të mëdha, rreth 180 - 200 g, ngjyrë e verdhë intensive, me shije të mirë e të veçantë. Është mesatarisht e vonë.

Kultivimi: Domate me cikël mesatarisht të gjatë. Mbillet në 10-15 maj dhe vjelja e prodhimit fillon pas 8-10 javë, në fund të korrikut–fillimi gushtit dhe vazhdon deri në ngjicat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 35 -40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* Mont de Bary) dhe temperaturave të ulëta.

Negative: Jep prodhim relativisht të ulët, por të qëndrueshëm.

Përdorimi:

E freskët për sallatë dhe gatime të ndryshme. Preferohet për konsum në familje.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.



Domatja “Çerre” e Tiranës

Specia: *Solanum lycopersicum* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme, kryesisht në zonën e ulët por edhe kodrat e Piskës e të Petrelës, njihet e kultivohet për më se 100 vjet. Fara e saj është mbajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së domates në zonë.

Përshkrimi:

Ka bimë me masë të vogël, tipi i kufizuar (e shkurtër) dhe lulëri të përbërë. Zakonisht formon 1-2 lulesa / bimë. Frutat janë të rrumbullakët dhe të vegjël, rreth 25-30 g, me ngjyrë e kuqe intensive, me shije të mirë. Është shumë e hershme.

Kultivimi: Mbillet në fushë në fund të muajit Mars e deri nga fillimi Prillit dhe vjelja e prodhimit fillon në Qershor dhe vazhdon deri në ditët e para të Korrikut.

Rendimenti:

rreth 25 -30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora infestans* (Mont) de Bary) dhe temperaturave të ulëta.

Negative: Jep prodhim të ulët.

Përdorimi:

E freskët dhe gatime të ndryshme. Preferohet për konsum në familje.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.



Speci i Laknasit

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Shqipërisë së mesme, fshatrat e Tiranës dhe Durrësit, njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes që mbillet me spec në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell të drejtë, me degëzim mesatar dhe ndërnyje të shkurtra. Gjethe të dendura. Prodhon 10 – 20 fruta për bimë. Ata janë me formë prizmatike, me 3-4 lobe, peshë mesatare 60-80 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë të verdhë, kurse në atë biologjike të kuqe portokalli. Është spec me shije të veçantë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 15 prill - 15 maj. Vjelja fillon pas 7-9 javë, fund qershorit - fillim korrikut dhe vazhdon deri në tetor.

Rendimenti:

rreth 25-30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim në formë turshie, të mbushur me gjizë, etj, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje



Speci Peza

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Shqipërisë se mesme, fshatrat e Tiranës dhe Durrësit, njihet dhe kultivohet për më se 60-70 vjet. Mendohet se është me orgjinë nga Bullgaria. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët. Aktualisht, zë më pak se 5% të sipërfaqes që mbillet me spec në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë të larta 65-70 cm, me kërcell të drejtë, degëzim mesatar dhe ndërrnyje të shkurtra. Gjethe të dendura. Prodhon 20-25 fruta për bimë. Ata janë formë trekëndëshi të zgjatur, me dy brazda gjatësore (depresione të dobëta mes mesit dhe majës), me peshë mesatare 80-90 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër të errët, kurse në atë biologjike të kuqe intensive. Tuli është i trashë (4-5 mm), i ngjeshur dhe i lëngshëm. Është spec me shije të mirë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10 - 15 maj. Prodhimi fillon pas 8-10 javë, në fund të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 35-40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim në formë turshie, të mbushur me gjizë, etj, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje



Speci Gogozhare

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar ndër breza nga bahçevanët. Aktualisht, zë më pak se 5% të sipërfaqes së mbjell me spec në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimët kanë trup të ulët 40-45 cm, kërcell të trashë dhe me pak degëzime. Gjethe të mëdha, të gjera, eliptike dhe me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 7-10 fruta për bimë. Ata kanë formë të rrumbullakët ploçakë (si domate), me 6-8 brinjë, peshë mesatare 80-100 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër të errët, kurse në atë biologjike të kuqe intensive. Fryti, në përgjithësi ka tre fole, por ka raste edhe me katër fole të farërave. Tuli është shumë i trashë dhe i ngjeshur. Është spec i ëmbël, i lëngshëm dhe me shije të mirë. Ky spec ka periudhë vegjetacioni gjysmë të vonë deri në të vonë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10-15 maj. Prodhimi fillon në muajin gusht dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 25-30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

I freskët, në sallata dhe gatime të ndryshme, por dhe përpunim, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; është në rrezik zhdukjeje.



Speci i Dukagjinit

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Dukagjinit, ku njihet edhe me emrat “Speci Somborka i Kosovës” dhe “Speci i Kosovës”, nga edhe ka ardhur. Kultivohet aty për më se 60-70 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Zë rreth 10-15% të sipërfaqes që mbillet me spec në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë shumë e degëzuar, tip kaçube, me ndëryje të shkurtra. Prodhon 20-25 fruta për bimë. Ata janë relativisht të vegjël, formë konike, peshë mesatare 55-70 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë të bardhë deri në të verdhë të hapur, kurse në atë biologjike të kuqe të plotë; pak djegës dhe me shije të veçantë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë në 1-15 maj. Vjelja fillon pas 8-10 javë, në fillim të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 25-35 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut (*Phytophthora capsici* Leon), temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatim dhe përpunim në formë turshie, të mbushur me gjizë, etj, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Nuk është në rrezik zhdukjeje.



Speci “Poçe e kuqe”

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës, Devollit dhe Pogradecit, njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar ndër breza nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së specit në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimët janë të larta 70-80 cm, kërcell mesatarisht të trashë dhe degëzim mesatar. Gjethe të mëdha, eliptike, me majë dhe me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 15-20 fruta për bimë. Ata janë të mëdha deri shumë të mëdha, formë prizmi me 4 brinjë (ka raste edhe me 6 brinjë), me peshë mesatare 80-120 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër, kurse në atë biologjike të kuqe intensive. Fryti, në përgjithësi ka tre fole. Tuli është i trashë (4-5 mm), i ngjeshur dhe i lëngshëm. Është spec i ëmbël, i lëngshëm dhe me shije të mirë. Ky spec është gjysmë i vonë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10 - 15 maj. Prodhimi fillon pas 8-10 javë, në fund të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 35-40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim në formë turshie, të mbushur me gjizë, etj, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje



Speci Vëthka

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar ndër breza nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së specit në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimët kanë trup mesatarisht të lartë 50-60 cm, kërcell të hollë e të drejtë, degëzim mesatar dhe ndërnyje të shkurtra. Gjethe të mëdha, të gjera, eliptike dhe me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 15-20 fruta për bimë. Ata janë mesatarisht të mëdhenj, me formë trekëndëshe të zgjatur, me majë, me peshë mesatare 80-90 g; në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër të çelur deri në të verdhë, kurse në atë biologjike të kuqe intensive. Tuli është i hollë (2.5-3 mm), i lëngshëm. Është spec me shije të mirë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10 - 15 maj. Prodhimi fillon në muajin korrik dhe vazhdon deri në tetor.

Rendimenti: rreth 20 - 25 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve dhe temperaturës së ulët.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshetet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje.



Speci “Poçe e verdhë”

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Edhe kjo popullatë, sikurse “Poçe e kuqe”, në zonën e Korçës, Devollit dhe Pogradecit, njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara e saj është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar ndër breza nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së specit në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimët kanë trup të lartë 70 -80 cm, me kërcell mesatarisht të trashë dhe degëzim mesatar. Gjethe të mëdha, eliptike, me majë dhe me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 15-20 fruta për bimë. Ata janë të mëdha deri shumë të mëdha, formë prizmi me 4 brinjë (ka raste edhe me 6 brinjë), me peshë mesatare 80-100 g; në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër të çelur deri në të verdhë, kurse në atë biologjike ngjyrë portokalli të kuqe. Fryti, në përgjithësi ka tre fole. Tuli është i trashë (4-5 mm), i ngjeshur dhe i lëngshëm. Është spec i ëmbël, i lëngshëm dhe me shije të mirë. Edhe ky spec është gjysmë i vonë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10 - 15 maj. Prodhimi fillon pas 8-10 javë, në fund të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 35-40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi: Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim në formë turshie, të mbushur me gjizë, etj, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje.



Speci Hundashkë

Specia: *Capsicum annuum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës njihet dhe kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së specit në zonë.

Përshkrimi:

Bimët kanë lartësi 55-60 cm, kërcell të trashë e të drejtë, degëzim mesatar dhe ndërnyje të shkurtra. Gjethet janë të mëdha, të gjera, eliptike dhe me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 7-10 fruta për bimë, të cilët vendosen kryesisht në bazën e bimës. Ata janë mesatarisht të mëdha, me formë prizmi të zgjatur, me dhe pa majë, me peshë mesatare 70-80 g; në pjekjen teknike kanë ngjyrë të gjelbër të çelur deri në të verdhë, kurse në atë biologjike të kuqe. Tuli është i hollë (2.5-3 mm), i lëngshëm. Është spec me shije të mirë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë 10 - 15 maj. Prodhimi fillon në muajin korrik dhe vazhdon deri në tetor.

Rendimenti:

rreth 25-30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve dhe temperaturës së ulët.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, gatime të ndryshme dhe përpunim, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje.



Patëllxhani i Zall Herrit

Specia: *Solanum melongena* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet. Fara e tij është mbajtur dhe ruajtur nga vetë bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5-10 % të sipërfaqes që mbillet në zonë me këtë bimë.

Përshkrimi:

Bimë vitale, me kërcëj të drejtë e të lartë (mbi 100 cm), pak e degëzuar, me ndërrnyje të shkurtra dhe gjethë të mëdha. Kërcejtë dhe gjethet janë me ngjyrë jeshile në vjollcë, kurse lulet ngjyrë vjollcë. Prodhon 7-8 fruta për bimë. Ata janë të gjatë, cilindrik dhe me maj më të theksuar, me peshë mesatare 150 - 180 g. Në pjekjen teknike kanë ngjyrë violet, madje kur rriten në fruta formohen shirita të zbardhur, kurse në pjekjen biologjike marrin ngjyrë banane; tuli ngjyrë e bardhë.

Kultivimi: Farat mbillen në farishte në gjysmën e parë të muajit mars dhe fidanët në fushë në fund prillit e fillim të majit. Vjelja e prodhimit fillon në fund të qershorit - fillim të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 25-35 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Negative: Jep prodhim të ulët dhe në fruta formohen shirita me ngjyrë të zbardhët.

Përdorimi:

Për të freskët, gatime dhe përpunim në formë turshie, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje



Patëllxhani i Oblikës

Specia: *Solanum melongena* L.

Përhapja: Në zonën veriore kultivohet për më se 70-80 vjet, në Oblikë të Shkodrës edhe më shumë. Fara është mbajtur dhe ruajtur ndër breza nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes që mbillet në zonë me këtë bimë.

Përshkrimi:

Bimë vitale, tip kaçube, me kërcell të drejtë e të lartë (100-120 cm), mesatarisht të degëzuar, me ndëryje të shkurtra, gjethe të gjelbra e nuanca lela, lulet ngjyrë vjollcë. Prodhon 5-7 fruta për bimë; me formë të harkuar, të rrumbullakët dhe me maj të fryrë e të rrumbullakosur, me peshë mesatare 150 - 180 g. Në pjekjen teknike ata kanë ngjyrë violet të errët deri në të zezë, kurse në pjekjen biologjike marrin ngjyrë banane; tuli ngjyrë e bardhë.

Kultivimi: Farat e patëllxhanit të Oblikës mbillen në farishte në gjysmën e dytë të shkurtit dhe fidanët në fushë në fund prillit e fillim të majit. Vjelja e prodhimit fillon në fund të qershorit - fillim të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 25-35 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Negative:

Jep prodhim të ulët e fruta të harkuar.



Përdorimi:

Preferohet për konsum të freskët, gatime dhe përpunim në formë turshie për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje

Patëllxhani i Lunxhërisë

Specia: *Solanum melongena* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e jugut, kryesisht në fshatrat e Gjirokastrës dhe Përmetit, njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet. Fara e tij është mbajtur dhe ruajtur brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 10-15 % të sipërfaqes të mbjell në zonë me këtë bimë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcëj të drejtë, mesatarisht të degëzuar, me ndërnyje të shkurtra, lastar dhe gjethe të gjelbra, lulet ngjyrë vjollcë. Prodhon 7-8 fruta për bimë. Ata janë të gjatë (18-20 cm), të hollë (diametri 3-3.5 cm), cilindrik dhe me maj pak të harkuar, me peshë mesatare 90 - 100 g. Në pjekjen teknike frutat kanë ngjyrë violet të errët deri në të zezë, kurse në atë biologjike marrin ngjyrë banane; tuli ngjyrë e bardhë. Ata janë të shijshëm.

Kultivimi: Farat e patëllxhanit të Lunxhërisë mbillen në farishte në gjysmën e parë të muajit mars dhe fidanët në fushë në fund prillit e fillim të majit. Vjelja e prodhimit fillon në fund të qershorit - fillim të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti:

rreth 25-35 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Negative: Jep prodhim relativisht të ulët.

Përdorimi:

Preferohet për konsum të freskët, gatime dhe përpunim në formë turshie për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet pak dhe vetëm në kopshtet familjare; pra është në rrezik zhdukjeje.



Qepa e Drishtit

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Në zonën e Drishtit të Shkodrës njihet e kultivohet për mbi 200 vjet. Kjo qepë kultivohet thuajse në gjithë qarkun e Shkodrës. Fara është mbajtur, ruajtur e trashëguar nga kopshtarët. Zë rreth 30-35 % të sipërfaqes së qepës në zonë.

Përshkrimi:

Është mesatarisht e hershme. Karakterizohet nga bimë me shumë gjethe. Janë të gjata, me ngjyrë të gjelbër të çelur dhe që mbulohen nga një shtresë e hollë dyllore. Bulbet kanë madhësi mesatare. Luspat e jashtme, mbështjellëse të bulbit, kanë ngjyrë tjegulle, me nuanca më të errëta ose më të çelura. Luspat e brendshme kanë ngjyrë të bardhë qumështi. Ato përmbajnë 12-16% lëndë të thatë. Janë djegëse.

Qepa e Drishtit gjendet në dy forma kryesore:

a) Forma me bulb konike të zgjatur, me luspa të jashtme të trasha. Është forma që ruhet më mirë e më gjatë pas vjeljes.

b) Forma me bulb të rrumbullakët, me luspa të jashtme të holla. Ruhet për një periudhë relativisht më të shkurtër.



a)
“Drishti”
me bulbe
konik



b)
“Drishti”
me bulbe
të rrum-
bullakët

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me qepujkë .

Teknologjia: Për prodhimin e qepujkës fara mbillet në vllaja në periudhën 1–15 mars dhe qepujkat janë të gatshme për vjelje në fillim të gushtit. Pas vjeljes, thahen dhe ruhen në hangarë. Në vitin pasardhës, për prodhimin e qepës së thatë, qepujkat mbillen herët në pranverë, në largësitë 20x10-20 cm. Kryhen ujitje, plehërime dhe prashitje e bimëve. Prodhimi vjen për tu vjelë në gusht-shtator. Pas vjeljes, qepët thahen dhe ruhen në hangarë.

Rendimenti: rreth 25-30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm;

Përdorimi: Preferohet për konsum të freskët dhe gatim në familje.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje; s' është punuar për seleksionimin e prodhimin e farës.



Qepa e Mirasit

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës dhe Devollit njihet dhe kultivohet për më se 100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar ndër breza nga vetë banorët, me mbjellje të bulbeve më tipik e më të shëndetshëm. Aktualisht zë rreth 30-35 % të sipërfaqes së qepës në zonë.

Përshkrimi:

Bulbi ka formë konike. Pesha mesatare e tij rreth 250-300 g. Luspat e jashtme e ruajnë kompaktësinë për një periudhë të gjatë. Ato kanë ngjyrë bezhë të zbehtë e deri në të verdhë. Luspat e brendshme mishtore me trashësi 4-5 mm, janë të lëngshme dhe me ngjyrë të bardhë e deri në të verdhë. Numri tyre ndryshon në varësi të madhësisë së bulbit. Ka shije të mirë, të ëmbël qepe, për rrjedhojë konsumohet gjerësisht e freskët në sallata.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë . Fara për prodhimin e fidanëve mbillet gjatë shkurtit dhe fillimit të marsit. Fidani bëhet i gatshëm për tu mbjellë në fushë në dhjetëditëshin e tretë të majit e deri në dhjetëditëshin e parë të qershorit. Ato mbillen në fushë në largësitë 20 x 10 - 20 cm dhe prodhimi i qepës së thatë merret në periudhën shtator-tetor. Pas vjeljes, qepët thahen dhe ruhen në hangarë.

Rendimenti: rreth
25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm;

Negative: Bulbet nuk ruhen për periudhe të gjatë.



Përdorimi: Për konsum të freskët dhe gatim në familje.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Qepa e bardhë e Sukthit

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Në zonën e ulët e bregdetare kultivohet për më se 80 - 100 vjet. Mendohet se është me orgjinë nga Italia, e mbjellë që në fillim të shekullit të 20-të në fermën e Sukthit (Durrës). Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së qepës në zonë, duke qenë kështu kultivari autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bulbi ka formë të rrumbullakët, plloçak ana e rrënjëve dhe eliptik nga ana e kërcellit. Diametri i bulbit rreth 8-10 cm. Pesha mesatare e tij rreth 200-300 g, por nuk përjashtohen rastet kur arrijnë deri 400 g. Luspat e jashtme janë 2-3, me ngjyrë të bardhë në krem. Luspat e brendshme kanë trashësi 4-5 mm, janë të lëngshme dhe me ngjyrë të bardhë qumështi. Bulbet përmbajnë rreth 90-92 % ujë. Ka shije të mirë, të ëmbël qepe, për rrjedhojë konsumohet gjerësisht e freskët në sallata. Ato nuk ruhen për kohë të gjatë.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë. Fara për prodhimin e fidanëve mbillet gjatë korrikut e deri në fillim të gushtit. Fidanët mbillen në fushë gjatë shtator – tetorit, në largësitë 20 x 15 - 20 cm. Prodhimi i qepës së njomë merret në periudhën shkurt-maj, kurse për gjysmë të thatë në qershor-korrik të vitit pasardhës.

Rendimenti:

rreth 25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ruhet për kohë të gjatë.

Përdorimi: Për konsum të freskët dhe gatime.



Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Qepa e kuqe e Dishnicës

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Sipas dokumenteve, bujqit e Dishnicës dhe fshatrat periferike të Korçës e kanë kultivuar për më se dy shekuj. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët, me mbjellje të bulbeve më tipik e më të shëndetshëm. Aktualisht zë rreth 20-25 % të sipërfaqes së qepës në zonë.

Përshkrimi:

Bima formon masë të madhe gjethore. Bulbet janë të rrumbullakët, plloçak në pjesën e rrënjëve dhe pak të zgjatur e konik nga ana e kërcellit (Indeksi H/D=0.6-0.7). Ato kanë peshë mesatare 150-200 g. Luspat e jashtëm kanë ngjyrë të kuqe në tjegull. Megjithatë, nuancat e ngjyrës ndryshojnë në varësi të kushteve klimatike dhe të mjedisit të kultivimit. Luspat e brendshme janë me ngjyrë të bardhë qumështi dhe djegëse. Përmbajtja e lëndës së thatë në bulbe shkon nga 8 deri 14%. Kjo qepë dallohet për cilësi të mira konservuese, mund të ruhet normalisht për 5-6 muaj.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë. Fara mbillet në vllaja në gjysmën e dytë të shkurtit. Fidanët bëhen të gatshëm për tu mbjellë në fushë në dhjetëditëshin e parë të qershorit. Mbjellja bëhet me rreshta në largësitë 20 x 10 - 20 cm. Kryhen ujitje, plehërime dhe prashitje e bimëve. Prodhimi vjen për tu vjelë në shtator - tetor. Në zonën e ftohtë (Korçë e Dibër), gjatë kultivimit me fidanë, prodhimi është i gatshëm për tu vjelë pas 200-210 ditë nga mbirja e farës. Në zonën e ngrohtë, kjo qepë mund të kultivohet me qepujkë, periudha bimore zgjat 90-120 ditë. Pas vjeljes, qepët thahen dhe ruhen në hangarë.

Rendimenti:

rreth 25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme nga vruku (*Peronospora schleideni* Ung.). Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi: Për konsum të freskët dhe gatim në familje.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Qepa e Bënjes

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Në zonën e Përmetit njihet e kultivohet për më se 200 vjet. Bujqit përmetar i konsiderojnë këto qepë vendase, madje tregojnë se ishte pikërisht një fshatar i tyre, i cili duke mërguar aty nga fillimi i shekullit të 19-të, e përhapri qepën e Bënjes në disa vende të Evropës dhe Turqi. Aktualisht, zë rreth 30-35 % të sipërfaqes së qepës në zonë.

Përshkrimi:

Bimët formojnë masë të madhe gjethore, 10-12 gjethe me ngjyrë të gjelbër të errët. Bulbi ka formë të rrumbullakët-plloçake, me diametër 6.5-7.0 cm dhe lartësi 3.5-4.0 cm. Luspat e jashtme kanë ngjyrë kafe të çelët dhe me nuanca të verdha. Ato janë shumë të forta dhe e mbështjellin plotësisht bulbin. Tuli ka ngjyrë të bardhë në qumësht dhe është pak djegës. Numri i luspave të brendshme, në varësi të madhësisë së bulbit shkon në 5-6. Trashësia e tyre rritet duke filluar nga qendra në periferi, por mesatarisht ky tregues është 4-6 mm. Bulbi i qepës së Bënjes ka peshë mesatare 100-250 g.

Qepa e Bënjes dallohet për aftësi të mira konservuese. Prodhimi mund të ruhet për më se 6-7 muaj, ose sikurse thuhet në atë zonë “qepa zë qepën”

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me qepujkë . Fara mbillet në vllaja në periudhën 1 – 15 mars dhe qepujkat janë të gatshme për vjelje në fillim të gushtit. Pas vjeljes, thahen dhe ruhen në hangarë. Në vitin pasardhës, për prodhimin e qepës së thatë, qepujkat mbillen herët në pranverë, në largësitë 20 x 10 - 20 cm. Kryhen ujitje, plehërime dhe prashitje e bimëve. Prodhimi vjen për tu vjelë në gusht - shtator. Pas vjeljes, qepët thahen dhe ruhen në hangarë.

Rendimenti:

rreth 20-25 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është e qëndrueshme ndaj sëmundjeve.

Negative: Jep prodhim relativisht të ulët.

Përdorimi:

Për konsum të freskët e gatime.



Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Qepa e Linit

Specia: *Allium cepa* L.

Përhapja: Sipas dokumenteve dhe kujtimeve të bahçevanëve, të trashëguara deri në ditët tona, në fshatin Lin të Pogradecit njihet e kultivohet që në fillimin e shekullit të 19-të. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga banorët brez pas brezi, me mbjellje të bulbeve më tipik e më të shëndetshëm. Aktualisht zë rreth 30-35 % të sipërfaqes së qepës në zonë.

Përshkrimi:

Bulbi ka formë të rrumbullakët në plloçake. Ato janë me përmasa më të mëdha. Diametri i bulbit shkon rreth 8-12 cm. Peshë mesatare e tij rreth 260-300 g, por nuk përjashtohen rastet kur arrijnë deri 600-700 g. Luspat e jashtme janë 2-3 dhe kanë ngjyrë rozë të errët në vjollcë. Luspat e brendshme kanë trashësi 4-5 mm, janë të lëngshme dhe me ngjyrë të bardhë. Bulbet e saj përmbajnë rreth 85-90 % ujë. Ka shije të mirë, të ëmbël qepe, për rrjedhojë konsumohet gjerësisht e freskët në sallata. Bulbet e kësaj qepe ruhen mirë deri në muajin shkurt të vitit pasardhës.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë. Fara, për prodhimin e fidanëve, mbillet gjatë shkurtit dhe fillimit të marsit. Fidani bëhet i gatshëm për tu mbjellë në fushë në dhjetëditëshin e tretë të majit e deri në dhjetëditëshin e parë të qershorit. Fidanët mbillen në largësi të 20 x 10 - 20 cm dhe prodhimi i qepës së thatë merret në periudhën gusht - shtator. Pas vjeljes, qepët thahen dhe ruhen në hangarë.

Rendimenti: rreth 25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Preferohet për konsum të freskët dhe gatim në familje.



Risku:

Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Lakra “Mishe” e Korçës

Specia: *Brassica oleracea* convar. *capitata* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës, Devollit e Pogradecit njihet e kultivohet për më se 80-100 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së lakrës kokë që mbillet në zonë, duke qenë kështu një kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Kultivar mesatarisht i vonë. Bima ka masë të madhe. Gjethet janë shumë të mëdha dhe me bishta të trashë. Formon koka të rrumbullakëta, kompakte, me madhësi 8-12 kg. Gjethet e brendshme të kokës janë të holla, me ngjyrë të bardhë, të ëmbla në ngrënie.

Kultivimi: Farat mbillen nga gjysma e dytë e prillit e deri nga mesi i muajit maj. Fidanët mbillen në fushë 35-40 ditë pas mbirjes, gjatë muajit qershorit. Prodhimi fillon në fund tetorit dhe vazhdon deri nga mesi i muajit dhjetor, më tej kokat vilen e ruhen për konsum dimëror, me shtretër në tokë ose në hangarë.

Rendimenti:

rreth 45 -50 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Preket nga sëmundjet, si hernia (*Plasmodiophora brassicae*), vrugu (*Peronospora parasitica*) dhe alternaria (*Alternaria brassicae*). Nuk ka lidhje të rregullt të kokave.



Përdorimi:

Për konsum të freskët, për sallata dhe gatim, si dhe përpunim në formë turshi.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, sepse në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Lakra e Bilishtit

Specia: *Brassica oleracea* convar. *capitata* L.

Përhapja: Në zonën e Devollit njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të lakrës kokë në zonë, pra është një kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Kultivar i mesatarisht i vonë. Bima ka masë mesatarisht të madhe. Gjethet e jashtme janë të mëdha dhe të shtrira thuajse horizontalisht me tokën. Formon koka të rrumbullakëta, me kompakte se “Mishia”, me madhësi 6-8 kg. Gjethet e brendshme të kokës janë të holla, me ngjyrë të bardhë, të ëmbla në ngrënie dhe që ziejnë shpejt.

Kultivimi: Farat mbillen nga gjysma e dytë e prillit e deri nga mesi i muajit maj. Fidanët në fushë 35-40 ditë pas mbirjes, gjatë muajit qershorit. Prodhimi fillon në fund tetorit dhe vazhdon deri nga mesi i muajit dhjetor, më tej kokat vilen e ruhen për konsum dimëror.

Rendimenti: rreth 40 -50 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative:
Nuk ka lidhje të rregullt të kokave.

Përdorimi:
Për konsum të freskët, për sallata dhe gatim, si dhe përpunim në formë turshi.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, sepse në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Lakra e bardhë e Postribës

Specia: *Brassica oleracea* convar. *capitata* L.

Përhapja: Në zonën e Drishtit të Shkodrës njihet e kultivohet për më shumë se 100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së lakrës kokë që mbillet në zonë, duke qenë kështu një kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Kultivar i hershëm, i përshtatshëm për kultivim në këtë zonë. Bima ka masë mesatare. Gjethet kanë nervaturë të theksuar. Formon koka mesatare, me madhësi 4-5 kg. Ato janë të rumbullakëta, lehtësisht të shtypura në majë, me ngjyrë të gjelbër të çelur.

Kultivimi: Farat mbillen gjatë muajit maj dhe e deri në mes të qershorit. Fidanët mbillen në fushë 35-40 ditë pas mbirjes, në fund të qershorit deri nga mesi i korrikut. Prodhimi fillon pas 15-20 tetorit. Mund të ruhet në fushë deri nga mezi i muajit dhjetor, më tej kokat vilen e ruhen për konsum dimëror.

Rendimenti: rreth 40 -45 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka lidhje të rregullt të kokave.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, për sallata dhe gatim, si dhe për përpunim në formë turshi.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, sepse në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Lakra e Postribes

Foto E.Toma

Lakra e Voskopit

Specia: *Brassica oleracea* convar. *capitata* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës dhe Pogradecit njihet e kultivohet për më se 80 - 100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes që mbillet me lakër kokë në zonë, pra është një kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Kultivar i mesatarisht i hershëm. Bima ka masë mesatarisht të vogël dhe kocan të shkurtër 10 cm. Gjethet e jashtme janë të pakta, të ngritura lart, duke formuar një kënd rreth 45° (gradë) me aksin e bimës, me ngjyre të gjelbër të hapur. Formon koka të vogla, të rrumbullakëta, eliptike në pjesën e majës, shumë kompakte, me madhësi 2-3 kg. Gjethet e brendshme të kokës janë të holla, me ngjyrë të bardhë, të ëmbla në ngrënie.

Kultivimi: Farat mbillen nga gjysma e dytë e prillit e deri nga mesi i muajit maj. Fidanët në fushë 35-40 ditë pas mbirjes, gjatë muajit qershorit. Prodhimi fillon në shtator dhe vazhdon deri nga mesi i nëntorit.

Rendimenti: rreth 30-40 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka lidhje të rregullt të kokave. Preket nga sëmundjet e lakrës, si hernia (*Plasmodiophora brassicace*), vrugu (*Peronospora parasitica*) dhe alter-naria (*Alternaria brassicace*).

Përdorimi:

Për konsum të freskët, për sal-lata dhe gatim, si dhe përpunim në formë turshi.

Risku: Është në rrezik zhdukje-je, sepse në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Preshi Kasharit

Specia: *Allium porrum* L.

Përhapja: Në fshatrat e Tiranës njihet e kultivohet për më se 80 - 100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes që mbillet me këtë bime në zonë.

Përshkrimi:

Bima formon pak gjethe dhe kërcell të gjatë 40-60 cm, i cili në pjesën e poshtme vjen më i trashë, kurse pranë gjetheve më i hollë (formë “kopani”). Ka cilësi të mira organoleptike: përmbajtje të ulët celuloze dhe zien lehtë, është i ëmbël, pak djegës dhe i shijshëm në ngrënie. Nuk ka qëndrueshmëri të mirë ndaj të ftohtit.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë.

Teknologjia:

Fara për prodhimin e fidanëve mbillet gjatë muajit mars. Fidanët mbillen në fushë gjatë periudhës qershor – korrik, në largësitë 20-25 x 10-15 cm. Prodhimi fillon të merret në periudhën tetor e vazhdon deri në mars të vitit pasardhës.

Rendimenti: rreth 25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve.

Negative: Nuk ruhet për kohë të gjatë.

Përdorimi: Për konsum të freskët dhe gatim.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Preshi i Belortasë

Specia: *Allium porrum* L.

Përhapja: Në fshatrat e Korçës, Devollit e Pogradecit njihet e kultivohet për më se dy shekuj. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga banorët brez pas brezi, me përzgjedhje dhe mbjellje të bimëve më tipike e të shëndetshme. Aktualisht zë rreth 20-25 % të sipërfaqes së preshit në zonë.

Përshkrimi:

Bima formon pak gjethe, me ngjyrë të gjelbër të errët, kërcell cilindrik mjaft të gjatë 70-90 cm. Ka cilësi të mira organoleptike: zien lehtë, është i ëmbël, pak djegës dhe ka shije të mirë. Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj të ftohtit.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me fidanë .

Teknologjia:

Fara për prodhimin e fidanëve mbillet herët në pranverë, gjatë muajit shkurt e deri nga fillimi muajit mars. Fidanët mbillen në fushë gjatë periudhës maj-qershor, në largësi 20-25 x 10-15 cm. Prodhimi fillon të merret në periudhën tetor e vazhdon deri në mars të vitit pasardhës. Në këtë zonë ka përvoja të mira, për shkuljen e preshit në vjeshtën e vonë dhe ruajtjen e tij të shtratifikuar për konsum dimëror.

Rendimenti:

rreth 25 - 30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe të ftohtit.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi: Për konsum të freskët dhe gatim.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje; në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.



Mashurka kacavjerrëse “Jallija” e Shkodrës

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Në zonën e Shkodrës njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet, fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-20 % të sipërfaqes që mbillet në zonë, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell kacavjerrës, me tre-katër lastar. Prodhon 50 -75 bishtaja për bimë. Bishtajat janë me formë plloçake, me gjatësi 12-15 cm e gjerësi 1.0 -1.2 cm, me ngjyrë të verdhë dhe tul i bardhë.

Kultivimi: Farat mbillen dorë-dorë, nga muaji prill deri në gusht. Prodhimi fillon në gjysmën e dytë të qershorit dhe vazhdon deri vonë në vjeshtë.

Rendimenti:

rreth 12 -15 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Bishtajat nuk formojnë fijezim. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për prodhim të freskët në gatime, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, sepse në treg qarkullojnë paketa me farë të kultivarëve të huaj.



Sallatë jeshile e Alliasit

Specia: *Lattuca sativa* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet. Mendohet se është me origjinë nga Italia, mbjellë fillimisht në fermat bujqësore të Durrësit (Sukth) e Tiranës. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5-10 % të sipërfaqes që mbillet në zonë me këtë bimë, duke qenë kështu kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Kultivar i përshtatshëm për kultivim në fushë. Formon kokë të madhe të ngjeshur. Ka gjethe të mëdha, të rrudhosura e me anë të dhëmbëzuara, me ngjyrë jeshile të hapët.

Kultivimi: Kultivohet me fidanë, me moshë 30-35 ditë. Për prodhim të zgjatur dhe të vargëzuar gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës, mbillet në disa duar; çdo 20-30 ditë. Farat e dorës së parë mbillen në shkurt dhe fidanët në fushë në fund të marsit. Prodhimi fillon në muajin maj.

Rendimenti: rreth 7-10 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët në familje dhe për tregun lokal.



Risku: Ka rrezik zhdukjeje, sepse në treg qarkullojnë paketa me farë të kultivarëve të huaj.

Pjepri Qarrës i Tiranës

Specia: *Cucumis melo, var reticulatus. L.*

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme, kryesisht në zonën fushore, njihet e kultivohet për më se 100 vjet. Fara është mbajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5 % të sipërfaqes së mbjell me pjepër në zonë.

Përshkrimi:

Formon bimë me 3-4 lastar të rendit të parë, mesatarisht të gjatë. Gjethet janë të mëdha, ovale, me ngjyrë jeshile. Frutat janë të rrjetëzuar, oval, me ngjyrë të verdhë në portokalli, me madhësi 2-3 kg, por nuk përjashtohen rastet edhe të frutave deri 5.0 kg. Tuli ka ngjyrë portokalli, me konsistencë të butë, me aromë të mirë dhe ëmbëlsi mesatare.

Kultivimi: Mbillet me farë dhe fidanë. Në traditën e bahçevanëve mbillej me farë në gropëza të përgatitura mirë me pleh organik. Fara mbillet në fushë nga fundi muajit prill- fillimi majit dhe vjelja e prodhimit fillon në fund qershorit dhe vazhdon deri në gusht.

Rendimenti:

rreth 25 -30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Jep prodhim të hershëm, fruta aromatik dhe të ëmbël.

Negative:

Qëndrueshmëri mesatare ndaj sëmundjeve. Prodhimtari relativisht të ulët. Nuk i qëndron transporteve të gjata.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, në familje dhe tregun lokal.



Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.

Pjepri Farashuk i Korçës

Specia: *Cucumis melo* L.

Përhapja: Në Shqipërinë juglindore, kryesisht në rrethet Korçë dhe Devoll, njihet e kultivohet për më se 100-150 vjet. Fara e tij mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 10 % të sipërfaqes së mbjellë me pjepër në zonë.

Përshkrimi:

Formon bimë me 3-4 lastar të rendit të parë, mesatarisht të gjatë dhe ndërnjye të shkurtra. Gjethet janë mesatare, me lobe, me ngjyrë jeshile mesatare. Frutat janë eliptik, me lëkur të rrudhosur, me ngjyrë të verdhë dhe mozaik të gjelbër të errët, me madhësi 1.5 -2.0 kg, por nuk përjashtohen rastet edhe të frutave deri 3.0 kg. Tuli ka ngjyrë të verdhë-portokalli, me konsistencë të butë, me aromë të mire dhe ëmbëlsi mesatare. E veçanta e këtij pjepri janë farërat e mbledhura si lëmshe me placentën.

Kultivimi: Në traditën e bahçevanëve mbillej me farë në gropëza të përgatitura mirë me pleh organik. Fara mbillet në fushë në fillimi të majit dhe vjelja e prodhimit fillon në fund korrikut dhe vazhdon deri në gusht.

Rendimenti:

rreth 25 -30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Jep prodhim të hershëm, fruta aromatik dhe të ëmbël.

Negative:

Qëndrueshmëri mesatare ndaj sëmundjeve. Prodhimtari relativisht të ulët. Nuk i qëndron transporteve të gjata.

Përdorimi:

Përdoret për konsum të freskët, në familje dhe tregun lokal.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.



Pjepri Dimërak i verdhë

Specia: *Cucumis melo, var.inodorus* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme dhe jugore, njihet e kultivohet për më se 80-100 vjet. Në zonën e Tiranës njihet edhe si “Dimërak i Baldushkut”, kurse në zonën e Myzeqesë si “Pjepër dimërak”. Fara e tij mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5-10 % të sipërfaqes së mbjellë me pjepër në zonë.

Përshkrimi:

Formon bimë me 3-4 lastar të rendit të parë, të gjatë. Gjethet janë ovale, me madhësi mesatare, me ngjyrë jeshile mesatare. Frutat janë të rrumbullakët, formë sferë, me lëkur të lëmuar, me ngjyrë të verdhë dhe mozaik të gjelbër të errët, me madhësi 2.0 – 3.0 kg. Tuli ka ngjyrë të bardhë, me konsistencë të mirë, me aromë të mire dhe ëmbëlsi mesatare.

Kultivimi: Në traditën e bahçevanëve mbillet me farë në gropëza të përgatitura mirë me pleh organik. Fara mbillet në fushë në fund të muajit prill dhe fillimi i Majit, kurse vjelja e prodhimit fillon në gusht dhe vazhdon deri në tetor.

Rendimenti:

rreth 25 -30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Jep prodhim të vonë. Fruta me konsistencë të mirë dhe të ëmbël, të qëndrueshëm në transporte të gjata. Frutat mund të ruhen në hangarë, për 2-3 muaj.

Negative:

Qëndrueshmëri mesatare ndaj sëmundjeve. Prodhimtari relativisht të ulët.



Përdorimi:

Përdoret për konsum të freskët, në familje dhe tregun lokal.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.

Pjepri Dimërak i Kallmit

Specia: *Cucumis melo*, var.*inodorus* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme dhe jugore, njihet e kultivohet për më se 80-100 vjet. Në zonën e Myzeqesë njihet si “Pjepër Kallmi”, pasi ka qenë i njohur për prodhimin e tij në fshatin Kallm të Fierit. Fara e tij mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë më pak se 5% të sipërfaqes së mbjellë me pjepër në zonë.

Përshkrimi:

Formon bimë me 3-4 lastar të rendit të parë, të gjatë. Gjethet janë ovale, me madhësi mesatare, me ngjyrë jeshile të errët. Frutat janë eliptik të gjatë, me lëkur të rrudhosur, me ngjyrë të gjelbër e nuanca të verdha, me madhësi 2.0–3.0 kg. Tuli ka ngjyrë të bardhë, me konsistencë të mirë dhe ëmbëlsi mesatare.

Kultivimi: Në traditën e bahçevanëve mbillet me farë në gropëza të përgatitura mirë me pleh organik. Fara mbillet në fushë në fund të muajit prill dhe fillimi i Majit, kurse vjelja e prodhimit fillon në gusht dhe vazhdon deri në tetor.

Rendimenti: rreth
25 -30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Jep prodhim të vonë. Fruta me konsistencë të mirë dhe të ëmbël, të qëndrueshëm në transporte të gjata. Frutat mund të ruhen në hangarë, për 2-3 muaj.



Negative:

Qëndrueshmëri mesatare ndaj sëmundjeve. Prodhimtari relativisht të ulët.

Përdorimi:

Përdoret për konsum të freskët, në familje dhe tregun lokal.

Rreziku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.

Kungulli dimrit për pjekje

Specia: *Cucurbita maxima* L.

Përhapja: Në zonën e Alpeve, në veri të vendit, kultivohet për më se 80-100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 45-50 % të sipërfaqes që mbillet në zonë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell zvarritës, me lastar të gjatë. Prodhon 3-4 fruta për bimë; me formë cilindrike të shtypur, me gjatësi 20 – 25 cm e diametër 20-30 cm, me peshë mesatare 2,5-4,0 kg, nuk përjashtohen rastet edhe më të mëdha; në pjekjen teknike kanë ngjyrë jeshile të hapur, kurse në pjekjen botanike ngjyrë gri; tulli ka ngjyrë të verdhë në portokalli.

Kultivimi: Mbillet me farë në gropëza, në fund prillit dhe gjatë majit. Zakonisht mbillet në anë ngastrash e në ledhe, me largësi 2-2,5 m midis gropëzave në rresht. Po kështu, është e njohur praktika e mbjelljes së tij në bashkëshoqërim me misrin. Prodhimi fillon në fund të korrikut dhe vazhdon deri vonë në ngricat e vjeshtës. Pas kësaj frutat vilen dhe ruhen për konsum dimëror.

Rendimenti:

rreth 25-35 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për pjekje, për konsum dimëror në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Nuk është në rrezik zhdukjeje.



Kungulli i byrekut

Specia: *Cucurbita moschata* L.

Përhapja: Në zonën e Alpeve kultivohet për më se 70-80 vjet, fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 30-35 % të sipërfaqes që mbillet në zonë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell zvarritës, me lastar të gjatë. Prodhon 3-4 fruta për bimë; me formë cilindrike, me gjatësi 15-20 cm e diametër 20-25 cm, me peshë mesatare 1.5-2.0 kg, nuk përjashtohen rastet edhe më të mëdha; në pjekjen teknike kanë ngjyrë jeshile të errët, kurse në pjekjen botanike ngjyrë të verdhë dhe me mozaik jeshil; tuli ka ngjyrë të bardhë ose të verdhë.

Kultivimi: Mbillet me farë në gropëza, në fund prillit dhe gjatë majit. Zakonisht mbillet në anë ngastra e në ledhe, me largësi 2-2,5 m midis bimëve. Po kështu, është e njohur praktika e mbjelljes së tij në bashkëshoqërim me misrin. Prodhimi fillon në fund të korrikut dhe vazhdon deri vonë në ngricat e vjeshtës. Pas kësaj frutat vilen dhe ruhen për konsum dimëror.

Rendimenti: rreth 20-25 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.



Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për përgatitje të byrekëve, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Nuk është në rrezik zhdukjeje.

Kungulli i bardhë i verës

Specia: *Cucurbita pepo* L.

Përhapja: Në zonën e ulët e bregdetare kultivohet për më se 80 - 100 vjet. Mendohet se është me origjinë nga Italia, i mbjellë fillimisht në fermat bujqësore të Durrësit (Sukth) e Tiranës. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 5-10 % të sipërfaqes që mbillet në zonë, duke qenë kështu kultivari autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell kaçubor, me lastar të shkurtër. Prodhon 4-5 fruta për bimë; me formë cilindrike, me gjatësi 12-15 cm e diametër 3-4 cm, me peshë mesatare 120-150 g; në pjekjen teknike kanë ngjyrë jeshile të çelët, kurse tuli ngjyrë e bardhë. Në pjekjen botanike fryti ka ngjyrë të verdhë.

Kultivimi: Mbillet me farë dhe me fidanë. Farat mbillen në gropëza në fund të prillit deri fillim të majit. Për mbjelljet me fidanë, fara në farishte në gjysmën e parë të prillit dhe fidanët në fushë në fillim të majit. Largësia midis rreshtave 100-120 cm dhe midis bimëve në rresht 40-60 cm. Prodhimi fillon në gjysmën e dytë të qershorit dhe vazhdon deri në vjeshtë.

Rendimenti:

rreth 10-15 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive:

Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj vrugut dhe ndaj temperaturave të ulëta.

Negative:

Jep prodhim të ulët.

Përdorimi:

Për konsum të freskët dhe gatime, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Me futjen e farërave të importit po mbillet gjithnjë e më pak dhe vetëm në kopshtet familjare, pra është në rrezik zhdukjeje.



Kungulli “Stambolli” i Shkodrës

Specia: *Cucurbita moschata* L.

Përhapja: Në zonën e Shkodrës njihet e kultivohet për më se 100-120 vjet, fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së kungullit në zonë, duke qenë kështu kultivari autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell zvarritës, me lastar të gjatë. Prodhon 5-8 fruta për bimë; me formë dardhe, me gjatësi 25-30 cm e diametër 10-15 cm, me peshë mesatare 3.5-4.0 kg, nuk përjashtohen rastet edhe më të mëdha; në pjekjen teknike kanë ngjyrë jeshile të errët, kurse në pjekjen biologjike ngjyrë të verdhë - portokalli; tuli ka ngjyrë të verdhë-portokalli.

Kultivimi: Farat mbillen në gropëza të përgatitura me pleh organik, në fund të prillit deri fillim të majit. Zakonisht mbillet në anë ngastra e në ledhe, me largësi 2-2,5 m midis bimëve. Po kështu, është e njohur praktika e mbjelljes së tij në bashkëshoqërim me misrin. Prodhimi fillon në gjysmën e dytë të qershorit dhe vazhdon deri në vjeshtë. Pas kësaj frutat vilen dhe ruhen për konsum dimëror.

Rendimenti:

rreth 10-15 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve dhe ndaj ndryshimeve të temperaturave të ditës.

Negative: Jep prodhim të ulët.

Përdorimi:

Për përgatitje të byrekëve dhe gatime të ndryshme, në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Nuk është në rrezik zhdukjeje.



Bamja e Libohovës

Specia: *Abelmoschus esculentus* L.

Përhapja: Në Libohovë të Gjirokastrës dhe në fshatrat për rreth njihet e kultivohet për më shumë se 80 -100 vjet. Fara është ruajtur në breza duke e kultivuar nga bahçevanët. Në vitet 80-90 të shekullit kaluar ishte përhapur në gjithë rrethet e Shqipërisë së mesme dhe jugut, duke u bërë kështu kultivari bazë për furnizimin e qyteteve. Aktualisht, me futjen e farërave të importit, mbillet pak, duke qenë kështu kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell të lartë, rreth 1,3-1,5 m, me pak lastar, me mbulesë të mirë gjethore, me ngjyrë të gjelbër të errët. Prodhon 30-50 fruta për bimë; me formë konike, me gjatësi 7-10 cm e gjerësi 1,0-1,3 cm, me ngjyrë jeshile të hapët.

Kultivimi: Farërat mbillen gjatë prillit dhe deri në fillim të majit. Prodhimi fillon në qershor dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 15-20 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, veçanërisht bakteriozës. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum në familje dhe për tregun lokal.



Përdoret e freskët në gatime të ndryshme. Në disa familje të vjetra të qyteteve Libohovë, Përmet e Gjirokastrë frutat e pjekur vilen e thahen në vargje, për tu konsumuar në dimër.



Risku: Është në rrezik zhdukjeje.

Bamja e Oblikës

Specia: *Abelmoschus esculentus* L.

Përhapja: Në Oblikë të Shkodrës dhe në fshatrat për rreth njihet e kultivohet për më shumë se 70-80 vjet. Fara është mbajtur dhe ruajtur në breza nga fermerët. Aktualisht mbillet pak, duke qenë kështu specie dhe kultivar autokton i rrallë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell kaçubor, me shumë lastar. Prodhon 15-30 fruta për bimë; me formë konike, me gjatësi 7-10 cm e gjerësi 1,0-1,3 cm, me ngjyrë jeshile të hapët.

Kultivimi: Farërat, në ngastra të vogla e kopshte familjare, mbillen gjatë prillit dhe në fillim të majit. Prodhimi fillon në mes të korrikut dhe vazhdon deri në ngricat e para të vjeshtës.

Rendimenti: rreth 10 -12 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Preferohet për konsum në familje dhe për tregun lokal. Përdoret e freskët në gatime të ndryshme; në disa familje frutat vilen e thahen në vargje për konsum në dimër.



Risku: Është në rrezik zhdukjeje.

Hudhra e Korçës

Specia: *Allium sativum* L.

Përhapja: Në zonën e Korçës, veçanërisht tek bahçevanët e fshatit Bulgarec, njihet e kultivohet për më se 100 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së hudhrës në zonë, duke përberë kështu një kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Bima formon kërcell të gjatë e masë gjethore të madhe, me ngjyrë të gjelbër të çelur. Bulbet janë të rrumbullakët, me mbulesë të kuqe në lela, me peshe mesatare 30-40 g. Ato nuk janë shumë kompakte e shkoqen lehtë; më shpesh formojnë 5-6 thelpinj, të cilët kanë shije të fortë djegëse.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me thelpinj. Mbjellja e thelpinjve bëhet herët në pranverë (1- 15 mars), me brazda të cekëta, me largësitë 20 cm rreshti nga rreshti dhe 10-15 cm bima nga bima. Kryhen ujitje, plehërime dhe prashitje e bimëve, në mes rreshta. Prodhimi është i gatshëm për tu vjelë si hudhër e njomë në maj-qershor e për hudhër të thatë në korrik-gusht. Pas vjeljes, hudhrat e thata lidhen gërshetë e ruhen në hangarë.

Rendimenti: Për të njomë 15-20 kv/dynym, kurse për të thatë rreth 10-15 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të qëndrueshëm. Pas vjeljes ruhet në vargje për 5-6 muaj.

Negative: Preket nga ndryshku (*Puccinia allii*), veçanërisht kur mbillet në zonën e ngrohtë. Janë përkeqësuar cilësitë bimore dhe shpesh herë bulbet shpërbëhen lehtë.



Përdorimi: Përdoret si hudhër e njomë për konsum të freskët; e thatë për gatime të ndryshme.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, sepse në vite nuk është punuar për seleksionimin dhe prodhimin e farës.

Hudhra e Brojës

Specia: *Allium sativum* L.

Përhapja: Në zonën e Alpeve, kryesisht Kelmend, njihet e kultivohet për më se 100 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Zë rreth 10-15% të sipërfaqes së hudhrës që mbillet në zonë, duke qenë kështu kultivar i rrallë.

Përshkrimi:

Karakterizohet nga bimë që formon kërcell të gjatë e masë gjethore të madhe. Ato janë të gjata, me ngjyrë të gjelbër të errët. Bulbet janë të vogla, shpesh me 2-3 thelpinj të vegjël ose edhe pa thelpinj. Kultivohet kryesisht për hudhër të njomë.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet me thelpinj.

Teknologjia: Mbjellja e thelpinjve bëhet herët në pranverë (1-15 mars), në brazda të cekëta të hapura me shatë, me largësitë 20 cm rreshti nga rreshti dhe 10-15 cm bima nga bima. Kryhen ujitje, plehërime dhe prashitje e bimëve, në mes rreshta. Prodhimi është i gatshëm për tu vjelë si hudhër e njomë në maj-qershor e për hudhër të thatë në gusht-shtator. Pas vjeljes, hudhrat e thata lidhen gërshetë e ruhen në hangarë.

Rendimenti: Për të njomë 15-20 kv/dynym; për të thatë rreth 7-10 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të qëndrueshëm.

Negative: Janë përkeqësuar cilësitë biomore. Shpesh herë nuk formon thelpinj.

Përdorimi:

Për konsum të freskët dhe e thatë për gatim në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje, pasi në vite s'është punuar për seleksionimin e prodhimit e farës.



Panxhari i kuq perimor

Specia: *Beta vulgaris subsp. vulgaris* L.

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme dhe të jugut njihet e kultivohet për më se 70-80 vjet. Mendohet se është me origjinë nga Egjipti. Tek ne ka ardhur nga Italia, i mbjellë fillimisht në fermat bujqësore të Durrësit (Sukth) e Tiranës. Fara mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes së mbjell me domate në zonë.

Përshkrimi:

Panxhari kuq perimor është bimë dyvjeçare; në vitin e parë formon rrënjën mishtore, me formë të rumbullakët të zgjatur, me diametër 5 – 7 cm, me peshe mesatare 0.3 – 0.5 kg. Bimë ka zhvillim mesatar, me rozetë gjethore të zhvilluar. Gjethet kanë ngjyrë të gjelbër të errët, me nuanca të kuqe dhe nervaturë të kuqe. Në vitin e dytë del kërcelli lulor, i cili është i drunjëzuar dhe i degëzuar, që arrin 70 – 90 cm lartësi.

Kultivimi: Në varësi të zonave klimatike, farat mbillen dorë-dorë, nga muaji mars dhe deri në tetor. Me këto mbjellje prodhimi është gjithë vjetor. Mbjelljet e muajit mars e japin prodhimin në ditët e para të qershorit.

Rendimenti: rreth 20-30 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.



Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët në sallata, gatime të ndryshme dhe përpunim në formë turshie, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Ka rrezik zhdukjeje, sepse në treg qarkullojnë paketa me farë të kultivarëve të huaj.

Rrepa e bardhë e Thethit

Specia: *Brassica Rapa* L. subsp. *rapa* Thell

Përhapja: Në zonën e Alpeve njihet e kultivohet për më se 100 vjet. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht kultivohet në pak familje në zonë, kryesisht në fshatrat e Thethit, duke qenë kështu kultivar shumë i rrallë. Aty njihet me emrin lokal “Rrepça”.

Përshkrimi:

Rrepa është bimë dyvjeçare; në vitin e parë formon rrënjën mishtore, me formë të rrumbullakët të zgjatur, me diametër 8 – 12 cm, me peshe mesatare 1.5 – 2.5 kg. Bimë ka zhvillim mesatar. Gjethet kanë ngjyrë të gjelbër të errët.

Është e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Në vitin e dytë del kërcelli lulor, i cili është i drunjëzuar dhe i degëzuar, që arrin 90 – 120 cm lartësi.

Kultivimi: Rrepa kultivohet kryesisht për prodhim vjeshtor – dimëror. Në varësi të zonave klimatike, farat mbillen nga fundi muajit prill dhe deri në fund të muajit maj. Prodhimi fillon në ditët e para të shtatorit, për tu konsumuar në vijimësi edhe gjatë gjithë dimrit.

Rendimenti: rreth 8 - 10 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është mesatarisht e qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për konsum të freskët, në sallata dhe përpunim në formë turshi, për konsum në familje dhe për tregun lokal.

Risku: Është në rrezik zhdukjeje.



Majdanozi i vendit

Specia: *Petroselinum sativum* Hoffm

Përhapja: Majdanozi me gjethe të holla, është i njohur e i kultivuar në gjithë zonat e vendit për më se 150 vjet. Fara e tij mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 15-20 % të sipërfaqes së mbjellë.

Përshkrimi:

Kultivar vendi i përshtatshëm për kultivim në fushë, për prodhim gjethesh. Ka bimë delikate, me shumë degëzime të holla. Gjethet janë të holla, të brishta, aromatike.

Kultivimi: Mbillet në ngastra të vogla, në kopshte pranë shtëpive, në vende me ekspozicion nga dielli, toka të pasura me lëndë organike, dhe me mundësi ujitjeje. Fara mbillet direkt në vllaja. Ajo bëhet dorë-dorë, nga muaji mars deri në gusht, në zona të ngrohta vazhdon edhe më vonë. Prodhimi vjen për tu vjelë 45-50 ditë pas mbirjes së farës.

Rendimenti: rreth 7-10 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative:

Nuk ka.



Përdorimi:

Preferohet si perime aromatizuese e freskët dhe në gatime të ndryshme, në familje dhe për tregun lokal. Përdoret edhe në aromatizimin e turshive të patëllxhanit, etj.

Risku: Ka rrezik zhdukjeje, sepse në treg qarkullojnë paketa me farë të kultivarëve të huaj.

Kopra e vendit

Specia: *Anethum graveolens* L.

Përhapja: Kopra e vendit është formë e rrallë e kultivuar për më se 100-150 vjet në gjithë zonat e vendit. Fara e saj mbahet e trashëgohet brez pas brezi nga bahçevanët. Aktualisht zë rreth 15-20 % të sipërfaqes së mbjellë në vend.

Përshkrimi:

Kultivar vendi i përshtatshëm për kultivim në fushë, për prodhim gjethesh. Ka bimë delikate, me shumë degëzime të holla. Gjethet me ngjyrë të gjelbër të errët, janë të holla, të brishta, aromatike.

Kultivimi: Mbjellja e koprës bëhet direkt me farë në vllaja. Ajo bëhet dorë-dorë, nga fillimi i muajit mars deri në gusht, në zona të ngrohta edhe më vonë. Prodhimi vjen për tu vjelë 45-50 ditë pas mbirjes farës.

Rendimenti:

rreth 7-10 kv/dynym.

Veçantitë:

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Preferohet për konsum si aromatizuese e freskët dhe gatime, në familje dhe për tregun lokal. Përdoret edhe në aromatizimin e turshive të ndryshme, etj.



Risku: Ka rrezik zhdukjeje, sepse në treg qarkullojnë paketa me farë të kultivarëve të huaj.

Fasulja “Shijaku”

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Fasulja “Shijaku” është përhapur në mjaft zona të Shqipërisë. Ajo kultivohet në rreth 65-70 % të sipërfaqes që mbillet me fasule në shkallë vendi.

Është kultivar autokton i gjetur në Shijak të rrethit të Durrësit; është kultivuar e bashkëshoqëruar me misër. Në vitet '50 filloi të kultivohej si kulturë e veçantë. Mendohet se mund të jetë sjellë nga Italia, por kultivohet prej një kohe të gjatë në zonën e Shijakut prej nga ka marrë emrin. Periudha bimore është 100-120 ditë.



Është bimë e tipit gjysmë e kufizuar, me lule të bardha, me bishtajë në formë shpate, me gjatësi 8-11 cm. Ka kokërr të bardhë, me peshë të 1000 kokrrave 450-500 g.

Kushtet e kultivimit: Kërkon toka të pasura dhe të freskëta. Mbillet në toka nën ujë dhe është e ndjeshme ndaj thatësisë dhe temperaturave të larta.

Nuk duron lagështirën e tepërt sidomos ujitjen gjatë ditës në periudhën me temperatura të larta pasi janë të dëmshme për prodhimin.

Përshkrimi: Dallohet për pjekje uniforme të farës, preket pak nga sëmundje e ndryshkut, ka nevojat të mëdha për ujë në lulëzim–formim bishtaje.

Kultivimi: Tradicionalisht kultivohet në zonën e Shijakut por mbillet në sipërfaqe të gjerë në zonën e ulët dhe bregdetare të vendit.

Rendimenti: rreth 35-50 kv/ha në prodhimin të gjerë.

Veçantitë

Pozitive: Pjekja e uniforme e farës dhe prodhim i lartë, përbëjnë dy tipare kryesore pozitive të fasules “Shijaku”.

Negative: preket pak nga sëmundje e ndryshkut

Përdorimi: Për gatime e konsum në familje dhe për treg.

Risku: Nuk ka.

Fasulja “Kallmeti”

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Fasulja “Kallmeti” është përzgjedhur që në shekullin e 18-të dhe mbillej kryesisht në rrethet Lezhë, Shkodër, Krujë. Tani përbën rreth 20% të sipërfaqes së mbjellë me fasule në vendin tonë, duke u kultivuar më shumë në hamullore pas të lashtave, patates së hershme etj. Në zonën e Zadrimes kjo fasule emërtohet edhe “Shtatë javëshe” për shkak të periudhës bimore shumë të shkurtër që arrin rreth 70 ditë e përbën kultivarin e fasuleve tona me pjekje nga më të hershmet, prandaj mund të merren edhe 2 deri 3 prodhime në vit.

Kushtet e kultivimit: Duron lagështirën e tepërt sidomos të vjeshtës, aq të dëmshme për prodhimin, si dhe hijezimin çka lejon mbjelljen edhe në pemëtore

Përshkrimi: Dallohet për pjekje të njëtrajtshme të farës, preket pak nga sëmundje e ndryshkut, i duron mirë temperaturat e larta në lulëzim–formim bishtaje, i vendos bishtajat lart në kërcell për mos t’u dëmtuar nga lagështira e tepërt e tokës.

Kultivimi: Fshati Kallmet, tradicionalisht e ka mbjellë fasulen edhe të bashkëshoqëruar me ullirin.

Rendimenti: rreth 25 kv/ha në prodhimin tonë të gjerë

Veçantitë

Pozitive: Pjekja e njëtrajtshme e farës dhe hershmëria, përbëjnë dy tipare kryesore pozitive të fasules “Kallmet”, e përzgjedhur pikërisht nga populli i kësaj zone.

Negative: preket pak nga sëmundje e ndryshkut.

Përdorimi:
Për gatime e konsum në familje dhe për treg.

Risku: Nuk ka.



Fasule e “Shalës”

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Në të gjithë krahinën e Dukagjinit-Shkodër.

Kultivohet për më se 60-70 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 45-50% të sipërfaqes që mbillet me fasule në zonë, duke qenë kështu kultivari autokton më i përhapur.

Kushtet e kultivimit: Mbillet në ngastra të sheshta, toka të thella e të pasura dhe me mundësi ujitjeje.

Përshkrimi:

Formon bimë të shkurtër e kaçubore; kokërr të vogël e të bardhë.

Kultivimi: Fasule me cikël të shkurtër; mbillet në 10-15 maj dhe vilet në mes të gushtit. Në zonë njihet ndryshe edhe si fasule “7 - jaushe”, çka do të thotë “7 - javësh”.

Teknologjia: Mund të mbillet në ngastër më vete, por shpesh mbillet në bashkëshoqërim me misrin e vendit “Farë deti”, në mes të rreshtave të misrit, në rresht më vete. Pas mbjelljes së misrit dhe mbirjes së tij, në mes rreshtave hapet me shatë një brazdë ku bëhet mbjellja. Fasulja përfiton nga shërbimet që i bëhen misrit.

Rendimenti: rreth 1-1,5 kv/dynym.

Veçantitë:

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Jep prodhim të lartë e të qëndrueshëm. Zien shpejt dhe është me shije të veçantë.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi: Për gatime e konsum në familje dhe për treg.

Risku: Nuk ka.



Grosha e shkurtër “Laramane e kuqe”

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Në të gjithë krahinën e Dukagjinit dhe Kelmendit-Shkodër, por edhe në Margegaj të Tropojës. Njihet edhe me emrin “Grosha e kuqe”.

Kultivohet këtu për mbi 200 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë 20 - 25% të sipërfaqes fasules në këto zona.

Kushtet e kultivimit: Mbillet në ngastër më vete, toka të sheshta, të thella e të pasura dhe me mundësi ujitjeje.

Përshkrimi:

Formon bimë të shkurtër e kaçubore; bishtaja të mëdha me ngjyrë laramane (me mozaik ngjyrë të kuqe-violet), kokërr mesatarisht të madhe, me ngjyrë laramane të kuqe.

Kultivimi: Fasule me cikël relativisht të shkurtër; mbillet në 10-15 maj e vilet në fund të gushtit deri fillim shtatori. Në vite të veçanta (kur dimri vjen shpejt) nuk piqen gjithë bishtajat dhe vështirësohet tharja e prodhimit të vjelë.



Teknologjia: Pas plehërimit me pleh organik (40-50 kv/dynym) dhe përgatitjes së tokës, bëhet mbjellja me makinë mbjellëse, me largësi të rreshtave 60 cm dhe 5-7 cm fara nga fara (dendësi 22-25 bimë/m²); në sipërfaqe të vogla mbillet me parmendë ose me brazda të hapura me shatë. Bëhen ujitje e prashitje sipas nevojës.

Rendimenti: rreth 1,5 -2,0 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Jep prodhim të lartë e të qëndrueshëm.

Zien shpejt dhe është me shije të veçantë.



Negative: Në vite të veçanta (kur dimri vjen shpejt) nuk piqen gjithë bishtajat.

Përdorimi: Në gatime e konsum në familje dhe për treg.

Risku: Nuk ka.

Grosha kacavjerrëse “Lekbibaj”

Specia: *Phaseolus vulgaris* L.

Përhapja: Në të gjithë krahinën e Nikaj-Merturit, Tropojë. Kultivohet për më se 70-80 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 30% të sipërfaqes që mbillet me fasule në zonë.

Kushtet e kultivimit: Mbillet në ngastra të sheshta, toka të thella e të pasura dhe me mundësi ujitjeje.



Përshkrimi:

Formon bimë kacavjerrëse; kokërr të bardhë në formë veshke.

Kultivimi: Mbillet në bashkëshoqërim me misrin. Mbillet 10 -15 maj dhe vilet në fillim të shtatorit.

Teknologjia: Mbillet në bashkëshoqërim me misrin e vendit (në çdo 3-4 bimë misri mbillet një bimë fasule). Fasulja përfiton nga shërbimet që i bëhen misrit; prodhon edhe në kushte me pak shërbime, pa përdorur plehra kimike dhe spërkatje.

Rendimenti: rreth 1,0 – 1,5 kv/dynym

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Jep prodhim të mirë e të qëndrueshëm.


Zien shpejt dhe është e pëlqyeshme për shijen e saj.

Negative: Ka vështirësi në vjelje, sepse ngatërrohet në misër.

Përdorimi:

Për gatime e konsum në familje dhe për treg.

Risku: Nuk ka.



Thierëza e “Vendreshës”

Lens culinaris ose *Lens esculentum* Medikus

Përhapja: Berat, Skrapar, Korçë, Kolonjë, Përmet, Tepelenë, Sarandë. Është kultivuar një varietet vendi i cili është quajtur thierëza e Vendreshës. Midis bishtajoreve për kokërr thierëza është specia më e vjetër. Kokrrat e thjerzës kanë përbajtje të lartë të proteinave 25-30 % si dhe janë të pasura me karbohidrate, fosfor, kalcium, hekur dhe vitamina B1. Kokrrat e thjerzës ziejnë 2-3 herë më shpejt se fasulja “Shijaku”.

Karakteristika kryesore:

Bimë njëvjeçare, vetë-pllenuese

Kërçelli: katër këndor me 2-3 degëzime, me lartësi 25-75 cm.

Gjethet: çift pendore me 2-8 çifte,

Lulëria: është vilë, e përbërë nga lule të vogla, me ngjyrë të bardhë, rozë, të kaltër.

Fruti: bishtajë, në formë rombi të sheshtë. Në kohën e pjekjes merr ngjyrë kafe të çelët. Numri i bishtajave për bimë shkon 35-60. Bishtaja përmban 1-3 fara por zakonisht dy, në formë lente ose të rrumbullakët. Pesha e 1000 kokrrave 20-75 g.

Kultivimi: Fara mbi në temperaturë 2-5°C dhe duron deri në -8°C. Zakonisht periudha bimore zgjat 3-6 muaj. Nuk ka kërkesa të veçanta për tokën dhe e lë të pasur tokën. Afti më i mirë i mbjelljes është 5-20 Shkurt ne zonën e ulët dhe 5-20 Mars ne zonën e lartë. Norma e farës duhet të jete 100-120 kg/ha që të sigurohen 300-400 bime për m².



Ky varietet jep një rendiment 15-18 kv/ha. Thierëza është një kulturë që duhet të përhapet për kultivim sidomos në zonat kodrinore e malore.

Qiqra “Holta”

Cicer arietinum L.

Është kultivuar që në kohët e lashta. Te k ne kultivohet në sipërfaqe tepër të kufizuara. Qiqra ka veti të mira biologjike dhe ekonomike pasi kultivohet edhe në toka të varfra dhe lehtësisht të kripura. Zonat kryesore të kultivimit në vendin tonë kanë qenë rrethet Elbasan, Gramsh, Korçë.

Karakteristikat: Bën pjesë në familjen Bishtajore (*Leguminosae*), specia *Cicer arietinum L.*

Bima: Kërçelli është i drejtë, me degëzime, me gjethe tek pendore. Bima është krejt e veshur me qime të forta. Lartësia e bimës shkon 20-50 cm. Llojet e qiqrës ndahen në dy grupe: me fara të mëdha që kanë periudhë bimore deri 140 ditë dhe me farëra të vogla me 65-75 ditë.

Qiqra është bimë njëvjeçare, vetpjal-muese.

Fruti: Është bishtajë e vogël që përmban zakonisht një deri në dy fara, rrallë tre.

Farat kanë madhësi dhe ngjyra të ndryshme. Pesha absolute shkon 160-350 g. Farat kanë majë të zgjatur. Për ushqim përdoren qiqrat me kokërr të bardhë, kurse për kafshët përdoren të gjitha llojet e qiqrës.

Kërkesat: Fara mund të mbijë në temperaturë +30C deri +40C. Nuk ka kërkesa të veçanta ndaj tokës, shkon mirë edhe në toka të varfra e të thata por jo në toka kënetore.

Është parabimë mjaft e mirë për të lashtat si dhe për bimët pranverore.

Mbjellja: kryhet herët në pranverë, me makinë mbjellëse, me rreshta në gjerësi 40 cm ose me rreshta çifte me 50 cm midis çifteve. Norma e farës shkon 80-120 kg/ha.

Shërbimet ndaj qiqrës janë prashitjet dhe heqja e barërave të këqija.



Lini i Vendit

(*Linum usitatissimum* L.)

Është nga bimët e kultivuara më të vjetra. Kultivohet për prodhimin e fijes, me të cilën prodhoheshin stofra të holla lini, thasë, mushama, tekstile për industrinë e automjeteve, litarë, etj. Më vonë në vendet e ngrohta u zëvendësua nga pambuku. Zonat kryesore të kultivimit në vendin tonë kanë qenë: Qarku i Elbasani, Beratit, Shkodrës dhe më pak në qarkun e Vlorës dhe të Gjirokastrës.

Përshkrimi: Lini bën pjesë në familjen Linaceae. është bimë njëvjeçare, vetëpllenuese.

Bima ka kërcell të gjatë 70-110 cm, cilindrik, me pak degëzime. Lini i gjatë kultivohet kryesisht për fije dhe është bimë e klimës së lagët, me periudhë bimore 80-90 ditë.

Fruti është boçe, e rrumbullakët. Farat janë vezake-plloçake, me ngjyrë kafe dhe rrallë të verdhë. Pesha absolute e farërave shkon 10-12 g.

Përmbajtja e vajit në farë është: yndyrë 33%. Vaji i linit përmban 80% linoleinë dhe ka përdorim për qëllime industriale dhe farmaceutike.

Kushtet e kultivimit: Klima më e përshtatshme është ajo e freskët- e lagët, me temperatura 8-10° C në fazën e parë.

Tokat më të përshtatshme janë ato pjellore, të përshkueshme, të pastër nga barërat e këqija.

Teknologjia: Mbjellja në zonën e ngrohtë bëhet në fund të shtatorit deri në 15 tetor, ndërsa në zonën e ftohtë në 1-30 mars. Norma e farës së linit për fije përdoret 150-180 kg/ha ndërsa për prodhim farë për vaj përdoret 40-50 kg/ha. Mbillet në thellësi 1,5-2 cm.

Shërbimet kryesore gjatë vegjetacionit janë: kullimi i parcelës dhe eliminimi i barërave të këqija.

Përdorimi:

Përdorimi kryesor aktualisht është për prodhimin e vajit dhe ne disa vende për prodhimin e fijes.



Koçkulla “Opari”

Lathyrus sativus L

Përhapja: Në vendin tone koçkulla është bimë e rrallë bishtajore e cila vite më parë është kultivuar në sipërfaqe të kufizuar në zonën juglindore të vendit, në tokat kodrinore-malore të rretheve Korçë, Berat, Skrapar, Përmet etj. Kultivari me i përhapur është “Opari”.

Përshkrimi: Është bimë bishtajore njëvjeçare. Lulet formë fluturë me ngjyrë të bardhë, rozë, të kuqërremta dhe disa janë dyngjyrëshe. Fryti bishtajë me 2-3 kokrra me ngjyrë të përzier të kokrrës (krem, e bardhë, e murrme, kafe, e zezë) dhe me formë të shtypur ose të çrregullt.

Kushtet e kultivimit: Është bimë tolerante ndaj thatësirës, temperaturave të larta e të ulta, sasive të pakta të lëndëve ushqyese, cilësive fiziko-kimike dhe mekanike të tokës dhe afateve të mbjelljes. Koçkulla fikson azotin atmosferik. Përdoret si para-bimë mjaft e mirë në sistemin e qarkullimit bujqësor të bimëve të kultivuara.



Teknologjia: Mbillet në vjeshtë, dimër dhe pranverë në të gjitha zonat e vendit si kulturë e veçantë por edhe si përzierje për prodhim foragjer.

Rendimenti: Në zonën fushore merren 350-450 kv/ha masë e njomë, ndërsa në zonën kodrinore-malore 200-250 kv/ha.

Veçantitë:

Pozitive: Tolerante ndaj thatësirës, temperaturave të larta e të ulëta, sasive të pakta të lëndëve ushqyese. Është bimë shumë e mire mjaltëdhënëse.

Negative: Nuk ka.

Përdorimi:

Për plehërim të gjelbër në vreshta, ullishta e pemëtore, si ushqim koncentrat për gjedhët si bar i njomë e i thatë për blegtorinë e imët. Prodhimi kokërr përderet si ushqim për njerëzit sidomos në përgatitjen e byrekëve.

Risku: Përdorimi i njëanshëm, sidomos në vite të thata çon në rritjen e përmbajtjes të acidit Oksalil-Diamino-Propionik (ODAP) që shkakton sëmundjen paralizuese të quajtur “Latirizëm”.



Kultivari i grurit “Dajti”

Specia: *Triticum aestivum* L.

Përhapja: Është grurë i butë, i krijuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 1976, nga kryqëzimi i kultivarëve Gemelli x Strampeli, përzgjedhur nga Mentor Përmeti. Është kultivuar me sukses në gjithë zonat e kultivimit të grurit në Shqipëri për një kohë të gjatë dhe vazhdon të kultivohet disa zona.

Përshkrimi:

Është tipi biologjik i hershëm-i hershëm, me vëllazërim të ngritur, me aftësi vëllazëruese të mirë dhe me pjekje të hershme.

Lartësia e bimës arrin 90-100 cm, kalliri me hala, me ngjyrë të kuqe, me lëfostra të hapura dhe me qëndrueshmëri të dobët ndaj shkoqjes.

Pesha e 1000 kokrrave është 40-42 g dhe pesha hektolitrike rreth 80-81 kg. Përmbajtja e proteinave është rreth 12-13 %.

Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj rrëzimit, mesatare ndaj ngricave dhe të ftohtit, shkon mirë në zonën e ulët por edhe në ato kodrinore e malore. Qëndrueshmëri të mirë ndaj ndryshqeve por ka prekjeje nga septorioza.

Kushtet e kultivimit: Kultivari “Dajti” është i përshtatshëm për toka mesatare e të shëndosha fushore por edhe kodrinore e malore deri në 600-900 m lartësi mbi detare.

Teknologjia: Afatet më të përshtatshme të mbjelljes në zonën e ftohtë janë në fillim të Tetorit deri në 10 Nëntor, ndërsa në zonën e ngrohtë gjatë Nëntorit. Norma e farës 220-240 kg/ha.

Rendimenti:
60-70 kv/ha

Veçantitë

Pozitive:

Kultivohet prej mbi 40 vjetësh dhe është bërë kultivar tradicional veçanërisht në rajonin e Korçës. Jep prodhim të lartë, të stabilizuar dhe me cilësisë të mirë.

Negative: Ka qëndrueshmëri të ulët ndaj shkoqjes.

Përdorimi: Mielli i kultivarit “Dajti” ka cilësi të mira për prodhimin e bukës.



Kultivari i grurit “Dumreja”

Specia: *Triticum durum* Desf.

Përhapja: Është kultivar tradicional në zonën e Dumresë në qarkun e Elbasanit por është kultivuar edhe në zonat e tjera kodrinore. Është grurë i fortë, i krijuar nga kryqëzimi midis kultivarit Halëziu (Kapeli) dhe një gruri të fortë (Meksikap), në vitin 1971.

Përshkrimi: Është tipi biologjik i vonshëm-i vonshëm. Kërcelli është i shkurtër 75-85 cm, i drejtë, i qëndrueshëm ndaj rrëzimit. Kalliri me hala të gjata e të zeza, i ngjashëm me halëziun, i ngjeshur, i drejtë, pjellor, me bosht të përkulshëm. Kokrra ka ngjyrë qelibari të ndritshme, me strukturë qelqore dhe gjysmë qelqore. Kristaliteti është 70-90 %, në varësi nga kushtet e motit, toka dhe agroteknika. Përmbajtja e proteinave në kokërr 13.5-15 % .

Kultivimi: Ka qëndrueshmëri të lartë ndaj shkoqjes dhe mund të mbillet me sukses në tokat kodrinore. Është i qëndrueshëm ndaj rrëzimit, ndryshkut të kërcellit, ndryshkut të gjethes por preket nga fuzarioza dhe hiri. Qëndrueshmëri të ulët ndaj të ftohtit dhe të lartë ndaj thatësirës. Kërkon toka pjellore, shkon mirë deri në 300-400 m lartësi mbi detare.

Teknologjia:

Parabimë të mira për këtë kultivarë janë bimët prashitëse. Afati i mbjelljes 1-20 Nëntor dhe norma e farës 210-230 kg/ha. Kërkon kullim të tokës të mirë dhe të vazhdueshëm.

Rendimenti: 40-50 kv/ha.

Veçantitë

Pozitive: Jep prodhim gruri të cilësisë shumë të lartë.



Negative: Jep më pak rendiment se gruri i butë.

Përdorimi: Për konsum për njerëzit si dhe për prodhimin e makaronave.

Risku: Nuk ka.

Thekra “Shishtaveci”

Specia: *Secale cereale* L.

Përhapja: Kultivohet në zonën malore të vendit tonë dhe kryesisht në Shishtavec te Kukësit, në Vithkuq e Voskopojë, te Korçës, etj., për më se 80 vjet.

Përshkrimi: Bimë njëvjeçare me kërcell të lartë 1.5-2 m, me ngjyrë të hirtë, me kokrra të murrme, të gjata e të holla. Në dallim nga drithërat e tjerë, është bimë me pjalmim të kryqëzuar.

Kushtet e kultivimit: Thekra mbillet kryesisht në zonat malore, në lartësi të madhe nga niveli i detit pasi ka qëndrueshmëri të mire ndaj temperaturave të ulëta. U përshtatet edhe tokave të varfra, ranore, lehtësisht të kripura.

Në zona shumë të larta, mbjellja fillon në ditët e fundit të Gushtit deri në fund të Shtatorit ndërsa në zonat më të ulëta, mbjellja kryhet gjatë Shtatorit deri në ditët e para të Tetorit.

Teknologjia: Parabimë më të mira për thekrën janë bimët që prashiten dhe bimët bishtajore. Në zonat ku ajo kultivohet shkon mirë edhe pas patates dhe bimëve foragjere.

Rendimenti: 40-50 kv/ha

Veçantitë

Pozitive: Rekomandohet si ushqim i personave me diabet. Ul kolesterolin së bashku me rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare, kancerin. Buka e thekrës nuk thahet si buka e grurit.

Negative: Jep më pak prodhim në toka të rënda

Përdorimi: Mielli i thekrës përdoret më tepër në përzierjet e miellit për bukë integrale.

Risku: Nuk ka.



Misri “Reçi i bardhë”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Në zonën e Shkrelit të Malësisë së Madhe kultivohet për më se 200 vjet. Sipas gojëdhënave, është sjellë nga Turqia në fshatin Reç në fillim të viteve 1800 nga Ibrahim Zogu, sikurse tregon stërnipi i tij, banor i Reçit, Xhemal Brahim Dacaj. Fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Zë rreth 15-20% të sipërfaqes që mbillet me misër në këtë fshat dhe ato rreth tij.

Kushtet e kultivimit: Në tarraca malore, me ekspozicion nga lindja, me toka të thella, të pasura me lëndë organike e të freskëta në verë. Kultivohet kryesisht në zona pa ujitje.

Përshkrimi: Bimët janë me shtat të mesëm, 170-180 cm, kërcell i veshur mirë me gjethe, kalli mesatar, me koçan e kokërr të bardhë, me konsistencë qelqore.

Kultivimi: Misër me cikël mesatarisht të mesëm, 90-94 ditësh; mbillet në mes të muajit prill dhe vilet në mes të muajit gusht.

Teknologjia: Plehërim organik me 40-50 kv/dynym, punim toke 20-25 cm, lesim, mbjellje me shatë në brazdë, ujitje, vjelje. Pa vjeljes prodhimi selekcionohet, thahet mirë dhe ruhet në koçekë druri për konsum në vijimësi.

Rendimenti: rreth 3,0- 4,0 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të qëndrueshëm; bën bukë të mirë e cilësore.

Negative: Prodhim i ulët.

Përdorimi: Për bukë e konsum në familje.

Risku: Është i rrezikuar. Aktualisht mbahet nga pak familje; rrezikohet zhdukja nga futja në prodhim e kultivarëve modern (hibride) të importit.

Shënim: Ja vlen të ruhet e të shtohet.



Misër “Sulova”

Specia: *Zea mays L.*

Është forma më e mirë e misrave të vendit; kultivuar për më se 200 vjet, jep rendiment të lartë. Mbillet në tokë nën ujë dhe mbi ujë.

Karakteristika kryesore janë:

Është misër i bardhë gjysmë qelqor.

Lartësia e bimës rreth 180 cm.

Paraqet kalli me gjatësi mesatare mbi 20 cm dhe me koçan shumë të hollë.

Rreshtat e kokrrave në kalli janë të drejtë.

Numri mesatar i rreshtave në kalli është 8.

Pesha mesatare e kallirit 150 g.

Pesha mesatare e kokrrave të kallirit 130 g.

Pesha e 1000 kokrrave rreth 370 g.

Raporti i peshës së kokrrave 85 %.

Ky kultivar është i përhapur kryesisht në qarkun e Elbasanit por edhe në rrethet Berat e Lushnje.

Përmbajtja e yndyrave	5.5 %
Përmbajtja e proteinave	10.6 %
Përmbajtja e lagështisë	20.8 %
Përmbajtja e amidonit	68.6 %
Pesha hektolitrike	72.8 kg



Është kultivar tradicional ne Qarkun e Elbasanit, mjaft i përshtatshëm për bukë dhe sidomos për prodhimin e ballokumeve.

Misër “Dukati i verdhë”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Në zonën e Vlorës dhe të Tepelenës kultivohet për më tepër se 200 vjet. Është formë që mbillet kryesisht në toka mbi ujë dhe jep rendiment të ulët.

Karakteristika kryesore janë:


Është misër i verdhë qelqor. Bimët janë me lartësi rreth 110 -120 cm. Paraqet kalli me gjatësi të vogël rreth 12-13 cm.

Numri mesatar i rreshtave në kalli është 11.

Pesha mesatare e kallirit 90 g.

Pesha mesatare e kokrrave të kallirit 68 g. Pesha e 1000 kokrrave rreth 230 g. Raporti i peshës së kokrrave ndaj kocanit është 81 %.

Kushtet e kultivimit: kryesisht në toka kodrinore e malore, në toka të pasura me lëndë organike e të freskëta. Kultivohet kryesisht në toka pa ujitje.



Misër me cikël të shkurtër, 85-90 ditësh; mbillet në mes të muajit prill dhe vilet në fillim të muajit gusht.

Teknologjia: Plehërim organik me 30-40 kv/dynym, punim toke 20-25 cm, lesim, mbjellje me shatë në brazdë, ujitje, vjelje. Pas vjeljes prodhimi seleksionohet, thahet mirë dhe ruhet në koçekë druri.

Rendimenti: rreth 3,0- 3,5 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj temperaturave të larta. Jep prodhim të qëndrueshëm; bën bukë të mirë e cilësore.

Negative: Prodhim i ulët.

Misër i bardhë vendi – “Farë deti”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Fshati Ndërllysë-Shalë-Shkodër. Kultivohet në zonë për më se 70 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 30% të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, toka të thella, me pjellori të mirë e të ujtitshme.

Përshkrimi

Bima: Bimë vitale, me lartësi 2,5-3 m, që formon 1-2 kallinj.

Kalliri: Mesatarisht i gjatë, me koçan dhe kokërr të bardhë; me 8 rreshta.

Kokrra: E bardhë, qelqore.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në dhjetëditorin e parë të shtatorit.



Teknologjia: Plehërim toke me 50-70 kv/dynym pleh organik, plugim 30-35 cm, lesim, mbjellje 70-80 x 30-35 cm, ujitje, prashitje dhe vjelje.

Rendimenti: 4-5 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Është prodhues; bën buke cilësore.

Negative: Rrezohet nga era.

Përdorimi: Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet nga kultivimi e të rrezikohet zhdukja nëse largohen familjet e vjetra e tradicionale. Rrezikohet edhe nga futja në prodhim e kultivarëve modern (hibride) të importit, të cilët janë më prodhues; kultivarët e importit ndikojnë edhe në prishjen e cilësive të misrit “Farë deti”, të cilat vijnë nga kryqëzimet e padëshiruara.



Shënim: Ia vlen të ruhet e të shtohet.

Misër vendi – “Misër Thethi”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Fshati Nënnavriq-Shalë-Shkodër. Kultivohet në zonë për më se 70 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Zë rreth 5-10% të sipërfaqes që mbillet me misër në këtë fshat dhe ato rreth tij.

Kushtet e kultivimit: Në tarraca malore, me ekspozicion nga lindja, me burime ujore pranë.

Përshkrimi:

Bimët janë me shtat të shkurtër, 120-150 cm, kërcell i veshur mirë me gjethe, kalli i vogël, koçan dhe kokërr të bardhë, qelqor.



Kultivimi: Misër me cikël të shkurtër, 80-85 ditësh; mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në mes të muajit gusht.

Teknologjia: Plehërim organik me 40-50 kv/dynym, punim toke 20-25 cm, lesim, mbjellje me shatë në brazdë, ujitje, vjelje.

Rendimenti: rreth 3.0 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta. Jep prodhim të qëndrueshëm; bën bukë cilësore.

Negative: Prodhim i ulët.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Është i rrezikuar, aktualisht mbahet nga pak familje; rrezikohet zhdukja nëse largohen familjet e vjetra e tradicionale.

Shënim: la vlen të ruhet e të shtohet.



Misër vendi – “Misër i bardhë i Vrithit”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Fshati Vrith-Shkrel-Malësi e Madhe, Shkodër

Kultivohet në këtë zonë për më se 60 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familjet e zonës. Aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes që mbillet me misër në këtë fshat dhe ato rreth tij.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta me prejardhje koluvione malore, pa ujë.

Përshkrimi:

Bimët janë me shtat mesatarisht të lartë, 180-230 cm, kalli mesatar me 8 rreshta, koçan dhe kokërr të bardhë, me konsistencë qelqore.



Kultivimi: Misër me cikël relativisht të shkurtër; mbillet në fillim të muajit maj dhe vilet në fund të muajit gusht.

Teknologjia: Plehërim organik me 40-50 kv/dynym, punim toke 20-25 cm, lesim, mbjellje me brazdë, vjelje e manipulim prodhimi.

Rendimenti:

rreth 2,5-3.0 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Ka qën-drueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe atyre të larta.

Jep prodhim të qëndrueshëm; bën bukë cilësore.



Negative: Prodhim i ulët.

Përdorimi: Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Është i rrezikuar, aktualisht mbahet nga pak familje; rrezikohet zhdukja nëse largohen familjet e vjetra e tradicionale.

Shënim: Ja vlen të ruhet e të shtohet.

Misër i bardhë vendi – “Misër i Selcës”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Fshatrat në rrjedhën e Selcës-Kelmend, Shkodër

Kultivohet në zonë për më se 80 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 15-20% të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, toka të thella, me pjellori të mirë e të ujtitshme.

Përshkrimi:

Bimë vitale, me lartësi 2,0 – 2,5 m, që formon 1-2 kallinj; kallinj mesatarisht të gjatë, me 8 rreshta; me koçan dhe kokërr të bardhë e qelqore.

Kultivimi: Mbillet në gjysmën e parë të muajit maj dhe vilet në fund të gushtit deri dhjetëditorin e parë të shtatorit.

Teknologjia: Plehërim me 50-70 kv/dynym pleh organik, plugim 30-35 cm, lesim, mbjellje me parmendë, rrallim, ujitje, prashitje, vjelje

Rendimenti:
5-6 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Është prodhues; bën bukë cilësore.

Negative: Prodhim relativisht i ulët me kosto të lartë.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet nga kultivimi e të rrezikohet zhdukja nëse largohen familjet e vjetra e tradicionale.

Shënim: Ia vlen të ruhet e të shtohet.



Misër i bardhë vendi – “Çelike”

Specia: *Zea mays L.*

Përhapja: Në zonën e Nikaj – Mërturit, Tropojë.

Kultivohet në zonë për më se 80 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Aktualisht zë rreth 30-40 % të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, toka të thella, me pjellori të mirë e të ujtitshme.

Përshkrimi:

Misër me cikël relativisht të gjatë. Bimë e lartë, 3-3,2 m, me kallë të gjatë; koçan i kuq, kokërr e bardhë, mesatarisht qelqore, përshtatur mirë për zonën.

Kallëri me 8 rreshta, me 32-35 kokërra në rresht.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në dhjetëditorin e parë të tetorit.

Teknologjia: Plehërim toke me 50-70 kv/dynym pleh organik, plug-im 30-35 cm, lesim, mbjellje 70-80 x 30-35 cm, ujitje, prashitje dhe vjelje.



Rendimenti: 5-7 kv/dynym. **Veçantitë**



Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Është prodhues; bën bukë të mirë e cilësore.

Negative: Nuk përshtatet në bashkëshoqërimin me fasule, sepse rrëzohet nga erërat.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet nga kultivimi e të rrezikohet zhdukja nëse largohen familjet e vjetra e tradicionale.

Shënim: Ja vlen të ruhet e të shtohet.

Misër i bardhë vendi – “Misri i Dragobisë”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Në zonën e Dragobisë, Tropojë. Është misër i njohur; kultivohet në zonë për më se 90 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Është pak i përhapur por përshtatur mirë për zonën, aktualisht zë rreth 10-15 % të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, kërkon toka të thella e të pasura dhe me ujë.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell relativisht të shkurtër e të trashë, me lartësi rreth 2-2,5 m, kalli konik me 12-14 rreshta dhe me 35-40 kokrra në rresht, koçan dhe kokërr të bardhë, qelqore.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në fund të muajit shtator.

Teknologjia: Plehërim toke me 50-70 kv/dynym pleh organik, plugim 30-35 cm, lesim, mbjellje 70-80 x 30-35 cm, ujë, prashitje dhe vjelje.

Rendimenti: 6-7 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Mund të bashkëshoqërohet me fasule, sepse ka kërcell të shkurtër e të trashë.

Është prodhues; bën bukë të mirë e me shije.

Negative: Kërkon toka të sheshta, me pjellori dhe ujë të shpeshta.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet dorë nga kultivimi i tij nëse ndryshon struktura e mbjelljeve në pjesën me toka të sheshta pranë Valbonës.

Shënim: Ja vlen të ruhet e të shtohet.



Misri “Morave vendi”

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Mbillet kryesisht në zonën rreth qytetit Bajram Curri (fshatrat Bujan e Llugaj), Tropojë. Është misër i njohur edhe në zonën e Dragobisë, ku kultivohet për më se 60 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Është pak i përhapur këtu dhe zë rreth 10% të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, kërkon toka të thella e të pasura dhe me ujtitje.

Përshkrimi: Bimë me kërcell relativisht të shkurtër e të trashë, me lartësi rreth 2-2,5 m, me kalli të madh, koçan dhe kokërr të bardhë, gjysmë qelqor, me cikël 95- 97 ditë.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në dhjetëditorin e parë të tetorit.

Teknologjia: Plehërim toke me 40-50 kv/dynym pleh organik, plugim 30-35 cm, lesim, mbjellje me brazda, rrallim duke i lënë bimët 70 x 30-35 cm, ujtitje, prashitje dhe vjelje.

Rendimenti: 6-7 kv/dynym.

Veçantitë:

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Mund të bashkëshoqërohet me fasule, sepse ka kërcell relativisht të shkurtër e të trashë si dhe sistem rrënjor të fuqishëm.

Është prodhues; bën bukë të mirë e me shije.

Negative: Kërkon toka të sheshta, me pjellori dhe ujtitje të shpeshta.

Përdorimi: Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet dorë, sepse ka pak toka të sheshta e të ujtitshme.

Shënim: Ia vlen të ruhet e të shtohet.



Misër vendi i Ismailajt

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Është misër i njohur në zonën e Dragobisë, Tropojës, ku kultivohet për më se 60 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Është pak i përhapur këtu, aktualisht zë rreth 10 % të sipërfaqes që mbillet me misër në zonë.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta, kërkon toka të thella e të pasura me lënde ushqyese dhe me ujitje.

Përshkrimi:

Bimë me kërcell relativisht të shkurtër, me lartësi rreth 2-2,3 m, me kalli të hollë, me 8-10 rreshta dhe me 34-36 kokrra në rresht, koçan dhe kokërr të bardhë, shumë qelqor, me cikël 87-90 ditë, pak i përhapur por përshtatur mirë për kushtet e luginës Valbonës.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në gjysmën e dytë të shtatorit.

Teknologjia: Plehërim toke me 40-50 kv/dynym pleh organik, plugim 30-35 cm, lesim, mbjellje me brazda, rrallim duke i lënë bimët 70 x 30-35 cm, ujitje, prashitje dhe vjelje.

Rendimenti: 4-6 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve, temperaturave të ulëta dhe të larta.

Mund të bashkëshoqërohet me fasule, sepse ka kërcell relativisht të shkurtër e të trashë si dhe sistem rrënjor të fuqishëm.

Është prodhues; bën bukë të mirë e me shije.



Negative: Kërkon toka të sheshta, me pjellori dhe ujitje të shpeshta.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të hiqet dorë, sepse ka pak toka të sheshta e të ujitshme.

Shënim: Ia vlen të ruhet e të shtohet.

Misri i i Bjeshkës

Specia: *Zea mays* L.

Përhapja: Është misër i njohur në fshatrat e Bjeshkëve të Tropojës (me lartësi 1100-1300 m), kryesisht në pllajën e Çeremit, ku kultivohet për më se 100 vjet; fara është mbajtur, ruajtur dhe trashëguar në familje brez pas brezi. Është pak i përhapur, aktualisht zë rreth 25-30 % të sipërfaqes që mbillet me misër në zonën e Bjeshkëve. Misri i Çeremit, njihet edhe me emrin “Misër i Bjeshkës”.

Kushtet e kultivimit: Në ngastra të sheshta e tarraca malore, me orgjinë kolvione malore.

Përshkrimi: Kultivar autokton me cikël të shkurtër, shumë i hershëm. Bimë me kërcell të shkurtër, 1,3-1,5 m, formon 1-2 calli për bimë; calli i vogël konik, me gjatësi 10-12 cm, me 12 rreshta dhe 18-20 kokrra në rresht, me koçan të bardhë, kokërr e verdhë e me konsistencë qelqore.

Kultivimi: Mbillet në mes të muajit maj dhe vilet në fund të gushtit.

Teknologjia: Plehërim toke me 40-50 kv/dynym pleh organik, plugim 20-25 cm, lesim, mbjellje me brazda 50-60 cm larg rreshti nga rreshti, ujitje, prashitje dhe vjelje.

Rendimenti: 3-4 kv/dynym.

Veçantitë

Pozitive: Është i qëndrueshëm ndaj luhatjeve të temperaturës, thatësisë dhe sëmundjeve të ndryshme.

Bën bukë të mirë e me shije.

Negative: Jep prodhim të ulët.

Përdorimi:

Për bukë, për konsum në familje.

Risku: Mund të rrezikohet zhdukja në se largohen familjet e vjetra e tradicionale.



Shënim: Ia vlen të ruhet e të shtohet.

Shesh i zi

Përhapja: Kultivar i vjetër autokton me prejardhje nga fshati Shesh i komunës së Ndroqit të rrethit të Tiranës, nga i cili merr edhe emrin. Sot ai gjendet i përhapur në të gjithë vendin tonë dhe zë vendin e parë për sasinë e sipërfaqes së mbjellë.

Përshkrimi:

Lastarët kanë rritje të fuqishme, me ngjyrë të gjelbër, me push. Në vjeshtë marrin ngjyrë të verdhë në kafe dhe në nyje ngjyrë violet. Gjethja është mesatare, me formë pesëkëndëshe, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të hapur. Lulja është dyseksore normale. Numri i lulërive për lastar shkon nga 2.1 deri në 3. Bistaku është i madh, me gjatësi mesatare, mesatarisht i ngjeshur. Kokrrat janë të rrumbullakëta, me madhësi mesatare, me ngjyrë blu në të zezë, me puhizë, me cipë mesatarisht të trashë, me 2 deri në 3 fara, pa aromë.

Karakteristikat agronomike:

Ky kultivar në toka me taban të thellë, të shkrifa e me përmbajtje gëlqerore jep prodhime të bollshme dhe cilësore. Duke qenë se karakterizohet nga sytha të bazës prodhues mund të aplikohen si krasitjet e shkurtra ashtu dhe ato të përziera. Shkon mire me nënshartesat Kobber 5 bb, 110 R, 1103 P. Preket nga sëmundjet kërpudhore, tenja, kalbëzimi. Grumbullon mesatarisht 23-25% sheqer, por në vite të veçanta sasia e sheqerit arrin 27%. Piqet vonë.

Përdorimi:

Kultivar kryesisht për prodhimin e verës për tryezë, me përmbajtje të lartë alkoolike, të qëndrueshme e me trup të plotë, por që përdoret shpesh edhe për konsum të freskët.



Debinë e zezë

Përhapja: Kultivar i vjetër, që njihet prej shekujsh, por nuk i dihet origjina. Është mjaft i përhapur në Përmet, Korçë, Leskovik, Gjirokastrë, Skrapar.

Përshkrimi:

Lastarët kanë zhvillim mesatar, me gjatësi mesatare të ndërnjave. Ne vjeshtë marrin ngjyrë të kuqërremte. Gjethja është e madhe , e rrumbullakët, me pesë lobe. Lulja është dysekore normale . Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar . Bistaku është mesatar, i gjatë, me kokrra jo të dendura. Kokrra është mesatare e rrumbullakët me puhizë të hollë, me cipë të trashë, me ngjyrë blu në të zezë, me fara.

Karakteristikat agronomike:

Preferon toka të thella, të pasura fushore, ndërsa në zona kodrinore e me mungesë ujitjeje nuk ka rritje të mirë dhe kokrrat mbeten të vogla. Rritet e prodhon mirë në zonat e larta të vreshtarisë por në zonën e ngrohtë piqet më mire dhe më shpejt. Ka diferencim të mirë të sythave të bazës. Më shumë preket nga vrugu. Nënshartesat kryesore janë Kobber 5bb, Shassella x Berlandieri 41B, 110 R. Grumbullon mesatarisht 22-24% sheqer. Piqet vonë.



Përdorimi: Ky kultivar është i destinuar për prodhimin e verërave të lehta të tryezës.

Kallmet

Përhapja: Është kultivar i vjetër me origjinë vendi. Ai ka gjetur përhapje në zonat e Lezhës, Shkodrës, Malësisë së Madhe, të cilat janë dhe vatrat e lashta të kultivimit të tij por edhe në Tiranë, Lushnje, Përmet. Shpesh njihet dhe me emra si Zadrimore, Gjashtore, Skadarka, Tokai i zi i Shkodrës.

Përshkrimi:

Ky kultivar karakterizohet nga lastar me rritje të fuqishme, me ngjyrë të gjelbër ,me shumë push. Në vjeshtë marrin ngjyrë kafe me nuançe vere. Gjethja është mesatare, pesëkëndëshe, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të mbyllur, me lobe të mbivendosura. Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar. Lulja është funksionale femërore. Bistaku është i madh , me gjatësi mesatare, jo i ngjeshur. Kokrra është mesatare , e rumbullakët, me ngjyrë të kuqe në violet, me puhizë të hollë, me cipë mesatarisht të trashë, i lëngshëm, me fara mesatare.

Karakteristikat agronomike:

Kallmeti është kultivar shumë i ndjeshëm ndaj kushteve ekologjike. Preferon toka të thata, të kulluara. Me që dëmtohet nga kalbëzimi kur ka shira në kohën e pjekjes është mirë që të mbillet në faqe kodrinore, të ngrohta e të ajrosura. Ai jep verëra të cilësisë së lartë në kushtet e zonës së ulët bregdetare. Duke qenë se ka lule funksionale femërore është mirë që në parcelë të ketë dhe kultivarë të tjerë që janë pjalmues të mirë. Kallmeti ka afinitet të mirë me të gjitha nënshartesat tona. Grumbullon 23-25% sheqer, në kushte optimale sasia e sheqerit arrin edhe 27%. Është kultivar me pjekje mesatare në të vonë.

Përdorimi:

Kultivar tipik për prodhimin e verërave të cilësisë së lartë, me ngjyrë rubini.



Vlosh

Përhapja: Kultivar i vjetër autokton, fillimisht i përhapur në zonën bregdetare të Jugut të vendit (Vlorë, Himarë) e sidomos në Nartë, Panaja, Trevllezër. Më vonë u shtri në tërë zonën e ngrohtë të Shqipërisë së Jugut dhe të Shqipërisë së Mesme.

Përshkrimi:

Ky kultivar karakterizohet nga lastar me rritje mesatare në ngjyrë të gjelbër. Në vjeshtë marrin ngjyrë kafe në të kuqërremtë. Gjethja është mesatare, me formë rrethore, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të hapur. Lulja është dyseksoare normale . Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar. Bistaku është mesatar, mesatarisht i ngjeshur. Kokrra është mesatare , jo uniforme, e rrumbullakët në vezake, me ngjyrë të kuqe të ndezur, me pak puhizë, i lëngshëm, me fara me madhësi mesatare.



Karakteristikat agronomike:

Preferon toka sub-argjilore të mesme. Jep prodhime të mira si në zonë fushore ashtu dhe kodrinore. Diferencon mirë në sythat e bazës, prandaj në mbjelljet e dendura me trup të ulët dhe krasitje të shkurtër ka siguruar prodhime të larta dhe cilësore. Është relativisht i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve kërpudhore. Nënshartesat më të mira janë 1103 P dhe Kobber 5bb. Grumbullon mesatarisht 22-24% sheqer. Piqet vonë.


Përdorimi: Është kultivar tipik për prodhimin e verërave deserte, alkoolike, me pak ngjyrë.

Shesh i bardhë

Përhapja: Kultivar i vjetër autokton me prejardhje nga fshati Shesh i komunës së Ndroqit të rrethit të Tiranës, nga i cili merr edhe emrin. Për vlerat e larta cilësore që mbart ka gjetur përhapje në shumë rrethe të vendit.

Përshkrimi:

Ky kultivar karakterizohet nga lastar me zhvillim të fuqishëm me ngjyrë të gjelbër. Ne vjeshtë marrin ngjyrë kafe të çelur. Gjethja është mesatare, me formë pesëkëndëshe, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit pak të hapur. Lulja është dyseksore normale . Prodhon 1.1-2 lulëri. Bistaku është mesatar, mesatarisht i ngjeshur. Kokrra është mesatare, e rumbullakët, e gjelbër në të verdhë, me puhizë të hollë, e lëngshme, me fara.



Karakteristikat agronomike:

Jep prodhime të larta në toka të pasura e të kulluara. Ka afinitet të mirë me shumë nënshartesa, por sidomos me Shassella x Berlandieri 41B, Kobber 5 bb, 1103 P. Diferencon mirë në sythat e bazës, prandaj nuk vërehen ndryshime në prodhim kur aplikohen sisteme të ndryshme të krasitjes. Rekomandohet të përhapet në zonat e ulëta dhe bregdetare, ku ka arritur të jap prodhime të bollshme e cilësore. Grumbullon mesatarisht 23-25% sheqer. Në vite të veçanta sasia e sheqerit arrin edhe 27%. Piqet vonë.

Përdorimi:

Është kultivar tipik për prodhimin e verërave harmonike dhe të këndshme, por që përdoret gjerësisht edhe në gjendje të freskët. Rekomandohet të përhapet gjerësisht në zonat e ulëta dhe bregdetare të vendit tonë deri në lartësinë 400-500m mbi nivelin e detit.

Debinë e bardhë

Përhapja: Kultivar i vjetër me origjinë vendi, produkt i seleksionimit të gjatë popullor. Është përhapur në zonat jugore të vendit tonë e kryesisht në Përmet, Leskovik, Korçë, Skrapar.

Përshkrimi:

Ky kultivar karakterizohet nga lastar me zhvillim mesatar. Në vjeshte marrin ngjyrë të kuqërremte. Gjethja është e madhe, pesë-këndesh, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të mbyllur, me lobe lehtësisht të mbivendosura. Lulja është dyseksore normale . Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar. Bistaku është mesatar, i gjatë, jo i ngjeshur. Kokrra është eliptike e shkurtër, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me pak puhizë, me dy fara.

Karakteristikat agronomike:

Është kultivar shumë prodhues dhe jep prodhime të bollshme në të gjitha llojet e tokave, por cilësinë e siguron në toka të shkrifa dhe në zona të lagëta. Diferencon mirë në sythat e bazës, prandaj mund të aplikohen sisteme të ndryshme të krasitjes. Preket më pak se kultivarët e tjerë nga sëmundjet kërpudhore. Grumbullon 22-24% sheqer. Piqet vonë.



Përdorimi: Ky kultivar është tipik për prodhimin e verërave të tryezës me cilësi të lartë.

Pulëz

Përhapja: Është kultivar i vjetër vendi, produkt i përzgjedhjes nga të parët tanë, i përhapur kryesisht në zonat e jugut të vendit tone si në Berat, Skrapar, Përmet, Tepelenë e Gjirokastrë, por edhe në Elbasan, Librazhd, Gramsh e Mat. Kultivohet kryesisht në formë pjergullash dhe hereke dhe shumë pak në formë vreshti. Shpesh emërtohet Verdhëza dhe Landari.

Përshkrimi:

Ky kultivar karakterizohet nga lastar me zhvillim mesatar, me push të dendur. Në vjeshtë marrin ngjyrë kafe të çelur. Gjethja është mesatare, pesëkëndëshe, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit shumë të hapur. Lulja është dyseksore normale. Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar. Bistaku është mesatar, i shkurtër, me kokrra shumë të dendura. Kokrra është e vogël në mesatare, jo uniforme, e rrumbullakët, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me pak puhizë, me cipë mesatarisht të trashë, i lëngshëm, me fara.

Karakteristikat agronomike:

Prodhueshmëria e lartë e sythave në të gjithë gjatësinë e sharmendës prodhuese bën që të japë prodhime të bollshme e cilësore si në krasitjen e shkurtër ashtu dhe të gjatë. Preket më pak nga hiri se kultivarët e tjerë. Rekomandohet të përhapet në zonat me lartësi deri në 700m mbi nivelin e detit. Grumbullon mesatarisht 21-23% sheqer. Piqet vonë.




Përdorimi: Në saj të cilësive të tij, ky kultivar destinohet për prodhimin e verërave të bardha të tryezës me përmbajtje të lartë alkooli.

Tajka e kuqe

Përhapja: Ky kultivar mendohet se e ka origjinën nga vendet e Ballkanit dhe të Azisë së vogël. Në vendin tonë ka gjetur përhapje në shumë rrethe të vendit (Tiranë, Librazhd, Skrapar, Përmet, Mat, etj) duke u kultivuar më shumë në formë pjergullash dhe herek, e më pak në formë vreshti. Ndryshimet e shumta që vërehen në gjirin e këtij kultivari, e kanë shndërruar atë në një popullatë. Shpesh njihet dhe me emrin Razaki e kuqe, Korith i kuq. Ndër format më të shquara është Tajga e kuqe e Burrelit, e cila konsiderohet edhe si forma përfaqësuese e më tipike e këtij kultivari.

Përshkrimi:

Lastarët kanë zhvillim të fuqishëm dhe ndërnyje të gjata. Në vjeshtë marrin ngjyrë lajthie të artë. Gjethja është e madhe, pesëkëndëshe, me shtatë lobe, me gropëzën e bishtit të mbyllur, me lobe lehtësisht të mbivendosura. Lulja është funksionale femërore. Prodhon mesatarisht deri në një lulëri për lastar. Bistaku është i madh, i gjatë, mesatarisht i ngjeshur. Kokrra është e madhe, vezake, me ngjyrë të kuqe, me puhizë të hollë, me cipë mesatarisht të trashë, me një farë, rrallë herë dy.



Karakteristikat agronomike:

Kultivar që nuk diferencon mirë në sythat e bazës, prandaj pëlqen krasitjet e gjata ose të përziera. Prodhimtaria është e lartë në sajë të peshës së madhe të bistakut. Rruhet mirë në pjergulla dhe mund të vilet edhe në nëntor, sidomos kur shirat e vjeshtës nuk fillojnë herët. Është mjaft i ndjeshëm ndaj vrugut, rezistence ndaj hirit e kalbëzimit. Lulëzimi i vonë dhe me kohë pa reshje është garanci për prodhime të larta e cilësore. Duhet të bashkëshoqërohet me kultivarë të tjerë që janë pjalmues të mirë. Meriton të përhapet në zonat e ulëta dhe bregdetare deri në lartësinë 700m mbi nivelin e detit. Nënshartesat më të përshtatshme janë Kobber 5 bb, SO4. Grumbullon mesatarisht 15-18% sheqer. Piqet vonë.

Përdorimi: Kultivar tipik për prodhimin e rrushit për konsum të freskët, me vlera të larta organo-shijuese dhe me qëndrueshmëri të lartë në transport.

Tajka e bardhë

Përhapja: Ky kultivar është importuar që në kohën e pushtimit turk nga Turqia, bën pjesë në grupin e razakie. Është më pak i përhapur se kultivari Tajgë e kuqe, por e gjejmë në Tiranë Krujë, Mat, Shkodër, Elbasan, Librazhd , kryesisht të kultivuar në formë pjergullash dhe herreke dhe shpesh njihet edhe me emrat Razaki e bardhë, Ragabardhë, etj.

Përshkrimi:

Lastarët kanë rritje të fuqishme e ndërnyje të gjata. Në vjeshtë marrin ngjyrë lajthie. Gjethja është e madhe, pesëkëndëshe, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të hapur. Prodhon mesatarisht deri në një lulëri për lastar. Bistaku është mesatar, i gjerë, mesatarisht i ngjeshur. Kokrra është e madhe, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me pak puhizë, me cipë të hollë, e lëngshme, me një farë, rrallë herë dhe dy.

Karakteristikat agronomike:

Ky kultivar preferon sistemet e krasitjes së gjatë dhe të përzierë, për shkak të diferencimit të dobët të sythave të bazës. Jep prodhime të mira kur është i bashkëshoqëruar me kultivarë të tjerë pjalmues. Është i ndjeshëm ndaj vrugut, hirit, thatësirës së gjatë. Duron vonesat në vjelje, kur kushtet e motit e favorizojnë. Meriton të përhapet në zonat e ulëta dhe bregdetare deri në lartësinë 600m mbi nivelin e detit. Grumbullon mesatarisht 16-19% sheqer. Piqet vonë.

Përdorimi:

Kultivar tipik për prodhimin e rrushit për konsum të freskët, me vlera të larta organo-shijuese dhe me qëndrueshmëri të lartë në transport.



Serinë e zezë

Përhapja: Nuk i njihet origjina, por është shekullor, mjaft i përhapur dhe i vlerësuar në rrethin e Korçës, Pogradecit, Përmetit, Skraparit e Leskovikut si për prodhimtarinë e tij ashtu dhe për vlerat e larta cilësore. Njihet edhe me emrin Lavardar.

Përshkrimi:

Lastarët kanë zhvillim mesatar. Në vjeshtë marrin ngjyrë të kuqërremtë. Gjethja është e madhe, me formë të rrumbullakët, me pesë lobe, me gropëzën e bishtit të hapur. Lulja është dyseksore normale. Prodhon 1.1-2 lulëri për lastar. Bistaku është mesatar, jo i ngjeshur. Kokrra është mesatare, e rrumbullakët, blu në të zezë, me cipë të trashë, me 2-3 fara të vogla.

Karakteristikat agronomike:

Preferon toka të thella, të pasura fushore, ndërsa në zona kodrinore e me mungese ujiti-jeje nuk ka rritje të mirë dhe kokrrat mbeten të vogla. Rritet e prodhon mirë në zonat e larta të vreshtarisë por në zonën e ngrohtë piqet më mire dhe më shpejt. Ka diferencim të mirë të sythave të bazës. Më shumë preket nga vrugu. Nënshartesat kryesore janë Kobber 5bb, Shassella x Berlandieri 41B, 110 R. Grumbullon mesatarisht 20-22% sheqer. Piqet vonë.

Përdorimi:

Ky kultivar është i destinuar për prodhimin e verërave të lehta të tryezës, që me vjetrim fitojnë karakteristika të veçanta.



Kultivarët e Mollës

Molla Gjyle

Përhapja: Gjendet në zonat veriore të vendit Kukës, Tropojë, Dibër etj.

Përshkrimi:

Pema është me rritje mesatare në të fuqishme, me kurorë të gjerë dhe të çrregullt. Degët janë të fuqishme dhe vishen me degëzime të shumta anësore. Lastarët njëvjeçar janë ngjyrë gri me lenticela të rrumbullakëta. Gjethja është mesatare, me formë ovale, me ngjyrë të gjelbër të errët dhe me shkëlqim, me anë të dhëmbëzuara. Lulja është me madhësi mesatare dhe me ngjyrë të bardhë. Fryti është me madhësi të vogël në mesatare, me formë globoze të shkurtër dhe zakonisht asimmetrik. Lëkura e frytit është e trashë, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë dhe mbi ngjyrim të kuq nga ana e diellit. Tuli është i bardhë në të gjelbër. Bishti i frytit është i shkurtër dhe i trashë. Kaliksi është i gjerë dhe jo i thellë.

Karakteristika të tjera:

Lulëzon vonë, në fund të prillit deri në fillim të majit. Frutat piqen në mes të tetorit dhe janë shumë të qëndrueshëm në transport. Ky kultivar është i ndjeshëm ndaj sëmundjes së kromës *Venturia inaequalis* Cooke (Wint.) dhe i qëndrueshëm ndaj krimbit të frutit. (*Cydia pomonella*).



Përdorimi:

Për konsum të freskët dhe për përpunim si komposto, reçel, prevede etj.

Molla Karapash

Përhapja: Gjendet në zonat juglindore të vendit, kryesisht në Korçë dhe Kolonjë.


Përshkrimi:

Pema është me rritje të fuqishme, me kurorë të rrumbullakët, me degë që tentojnë të rriten të drejta, të shtrira, të fuqishme, me ngjyrë gri. Gjethja është mesatare, me formë vezake të gjerë, me ngjyrë të gjelbër të errët. Lulja është me madhësi mesatare dhe ngjyrë të bardhë në rozë. Fryti është me madhësi mesatare, me formë të rrumbullakët dhe zakonisht simetrik por ka raste dhe asimetrik. Bishti i frytit është i shkurtër, mesatarisht i trashë dhe me push. Tuli është me ngjyrë të bardhë në të gjelbër, i lëngshëm, mesatarisht i fortë, i ëmbël, me aromë të lehtë. Lëkura e frytit është e lëmuar dhe e qëndrueshme, me ngjyrë bazë të gjelbër në të verdhë, me mbi ngjyrim me shirita me ngjyrë portokall në të kuqe. Sipërfaqja është e mbuluar me pikëzime me ngjyrë ndryshku.

Karakteristika të tjera:

Lulëzon vonë, në fund të prillit deri në fund të majit. Në kushte të favorshme klimatike dhe tokësore prodhon rregullisht. Frutat piqen në fund të muajit Tetor deri në fillim të muajit Nëntor dhe konsumohen menjëherë. Frutat janë të qëndrueshëm në transport, si dhe ndaj sëmundjes së kromës (*Venturia inaequalis* Cooke).

Përdorimi: Për konsum të freskët.



Molla Gjeçe

Përhapja: Ky kultivar e ka origjinën nga fshati Mollagjeçe i Elbasanit. Është i përhapur kryesisht në zonën e Shqipërisë së mesme (Elbasan, Tiranë etj.), por gjendet edhe në rrethe të tjera si Mat.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare, me kurorë të rrumbullakët dhe këndin e daljes së degëve të gjerë. Degët janë të fuqishme, ndërsa lastarët njëvjeçarë janë gri me lenticela të rrumbullakëta. Gjethja është e madhe, me formë eliptike, me ngjyrë të gjelbër të lehte, me buzë të dhëmbëzuara dhe të mprehta. Lulja është me madhësi mesatare dhe me ngjyrë të bardhë. Fryti është me madhësi mesatare, me peshtë mesatare, me formë të zgjatur dhe shpesh jo simetrike. Fryti ngushtohet në drejtim të kaliksit duke krijuar formë konike. Kaliksi është mesatar, i thellë dhe lehtësisht i ngushtë. Tuli është i fortë, i ëmbël, me aromë të lehtë. Bishti është i shkurtër dhe i trashë, i vendosur në një kavitet të thellë. Lëkura e frytit është e trashë me ngjyrim bazë të gjelbër në të verdhë, me mbi ngjyrim të kuq në pjesën më të madhe të frytit.

Karakteristika të tjera:

Lulëzimi është mesatar në të vonshëm. Frutat piqen në dhjetëditorin e parë të muajit Tetor dhe mund të ruhen në kushte shtëpie deri në fund të muajit Dhjetor. Ky kultivar është rezistent ndaj kromës së mollës (*Venturia inaequalis*) dhe i ndjeshëm ndaj krimbit *Cydia pomonella*.

Përdorimi: Për konsum të freskët si dhe për tharje. Gjatë periudhës së dimrit me frutat e thara përgatitet një çaj shumë i shijshëm.



Molla Hajvanie

Përhapja: gjendet i përhapur në juglindje të vendit, kryesisht në zonën e Përmetit dhe shpesh quhet edhe molla e Lupckës.

Përshkrimi:


Pema është me rritje mesatare në të fuqishme, me kurorë të gjerë. Degët janë të drejta dhe të trasha. Lastarët njëvjeçar janë gri me lenticela të rrumbullakëta. Gjethja është me formë ovale, e gjerë me ngjyrë të gjelbër, të lehtë. Lulet janë të mëdha dhe me ngjyrë të bardhë. Fryti është mesatar, në formë të rrumbullakët të sheshtë, zakonisht asimetrik. Bishti është i shkurtër në mesatar, mesatarisht i trashë. Kaliksi është i thellë dhe i gjerë. Lëkura e frytit është e gjelbër me mbi ngjyrim të kuq. Tuli është i bardhë, i lëngshëm, mesatarisht i fortë, me shije të ëmbël në të thartë të balancuar, me aromë.

Karakteristikat të tjera:

Lulëzimi është mesatar. Frutat piqet në mes të tetorit, dëmtohen lehtë gjatë vjeljes dhe transportimit. Konsumohen menjëherë mbas vjeljes dhe nuk ruhen gjatë.

Përdorimi:

Për konsum të freskët.



Molla Shëndëllia e Hoçishtit

Përhapja: gjendet në juglindje të vendit në Korçë, Hoçisht.

Përshkrimi:

Pema është me rritje të fuqishme, me kurorë të gjerë. Degët janë pak të përku-lura, të lëmuara. Lastarët njëvjeçar janë gri me lenticela të rrumbullakëta. Gjethja është mesatare, me formë ovale, me ngjyrë të gjelbër të lehtë hde buzë të dhëm-bëzuara. Lulet janë të mëdha dhe me ngjyrë të bardhë në rozë. Fryti është mesa-tar, në formë të rrumbullakët të sheshtë, zakonisht asimetrik. Bishti është i gjatë, i hollë. Kaliksi është mesatar. Lëkura e frytit është e trashë, e verdhë në të gjelbër me mbi ngjyrim të kuq në pjesën më të madhe të sipërfaqes. Tuli është i bardhë në krem, i lëngshëm, mesatarisht i fortë, i ëmbël , me aromë të këndshme.

Karakteristikat të tjera: Lulëzimi është i vonshëm. Frutat piqet në tetor, konsumohen menjëherë mbas vjeljes dhe ruhen deri në Janar. I ndjeshëm ndaj krimbit *Cydia pomonella*.

Përdorimi:

Për konsum të freskët.



Kultivarët e Dardhës

Bishtje

Përhapja: E gjejmë kryesisht në zonën qendrore dhe jugore të vendit.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare, në të fuqishme, në formë globoze, me degë me tendencë rritjeje drejt pak të varur, me ngjyrë kafe të çelur. Gjethja është vezake e rrumbulakosur, me ngjyrë të gjelbër të erret, pa push. Bishti i gjethes është me gjatësi mesatare. Fruti është mesatar, jo simetrik. Cipa e frutit është me trashësi mesatare, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë dhe mbingjyrim portokall. Bishti është mesatar në vazhdimësi të frutit. Tuli është i bardhë, me shumë lëng, më shumë i ëmbël se sa i thartë, me pak gurëza, në shijim të rrudh pak gojën, me pak aromë.

Karakteristika të tjera:

Lulëzimi ndodh zakonisht në dekadën e dytë të prillit. Piqet në fund të gushtit, fillimi i shtatorit dhe ruhet dy deri në tre javë pas vjeljes. Konsiderohet si kultivar rezistent ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Përdorimi:

Kryesisht për konsum të freskët, por edhe për përpunim.



Dimërore

Përhapja: Gjendet e përhapur në të gjithë vendin.

Përshkrimi:

Pema ka rritje të fuqishme, në formë globoze, me degë me tendencë rritjeje drejt pak të varur, me ngjyrë kafe, me pak lenticela. Gjethja është vezake me majë, me ngjyrë të gjelbër të lehtë, pa push. Bishti i gjethes është me gjatësi mesatare. Lulja është e bardhë, 8 deri në 10 lule në lulëri. Fruti është i vogël në mesatar, jo simetrik. Cipa e frutit është e trashë, me ngjyrë të gjelbër me mbingjyrim të kuq. Bishti i frutit është i gjatë. Tuli është i bardhë në të verdhë, me shumë lëng, më shumë i thartë se sa i ëmbël, me gurëza, mesatarisht rrudhës, pa aromë.

Karakateristika të tjera:

Lulëzimi ndodh zakonisht në dekadën e tretë të prillit. Pjekja mesatare në të vonë dhe ruhet dy deri në tre muaj pas vjeljes. Konsiderohet si kultivar rezistent ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Përdorimi:

Për konsum të freskët.



Elbore

Përhapja: Kryesisht gjendet në pjesën qendrore dhe jugore të vendit.

Përshkrimi:

Pema ka rritje të fuqishme, në formë piramidale të përmbysur, me degë me tendencë rritjeje drejt, me ngjyrë kafe të çelur, me pak lenticela. Gjethja është eliptike, me ngjyrë të gjelbër të errët, pa push. Bishti i gjethes është me gjatësi mesatare. Lulja është e bardhë, 6 deri në 10 lule në lulëri. Fruti është i madh, jo simetrik. Cipa e frutit është mesatarisht e trashë, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me mbingjyrim të kuq. Bishti i frutit është i gjatë. Tuli është i bardhë në të verdhë, me shumë lëng, më shumë i ëmbël se sa thartë, pa gurëza, me pak aromë.

Karakteristika të tjera:

Lulëzimi ndodh zakonisht në dekadën e dytë të prillit. Pjekja është shumë e hershme. Nuk ruhet pas vjeljes.

Përdorimi:

Kryesisht për konsum të freskët, por edhe për përpunim.



Sherbetlie

Përhapja: E gjejmë kryesisht në zonën qendrore të vendit, në Tiranë, Krujë, Elbasan.

Përshkrimi:

Pema ka rritje të fuqishme, në formë globoze, me degë me tendencë rritjeje të varur, me ngjyrë kafe me lenticela të ralla. Gjethja është vezake me majë, me ngjyrë të gjelbër, pa push. Bishti i gjethes është me gjatësi mesatare. Lulja është e bardhë. Ka 7 deri në 9 lule në lulëri. Fruti është i vogël në mesatar, jo simetrik. Cipa e frutit është me trashësi mesatare, me ngjyrë të gjelbër, me mbingjyrim të kuq, homogjen. Bishti është i gjatë. Tuli është i bardhë, me shumë lëng, më shumë i ëmbël se sa i thartë, me gurëza, nuk ta rrudh gojën, pa aromë.

Karakteristika të tjera:

Lulëzimi ndodh zakonisht në dekadën e dytë të prillit. Piqet herët dhe nuk ruhet pas vjeljes.

Përdorimi: Për konsum të freskët.



Bozongalli

Përhapja: E gjejmë kryesisht në zonën juglindore të vendit.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare në të fuqishme, me degë të shtrira, me tendencë rritjeje të varur, me ngjyrë kafe me lenticela të ralla. Gjethja është vezake, me ngjyrë të gjelbër, pa push. Bishti i gjethes është me gjatësi mesatare. Lulja është e bardhë. Fruti është mesatar, jo simetrik. Cipa e frutit është me trashësi mesatare, me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me mbingjyrim portokall të lehte. Bishti është i gjatë. Tuli është i bardhë në të verdhë, me shumë lëng, më shumë i ëmbël se sa i thartë, me pak qeliza gurore, nuk ta rrudh gojën, pa aromë.

Karakteristika të tjera:

Lulëzimi i hershëm në mesatar. Pjekja është e hershme në mesatare dhe nuk ruhet pas vjeljes. Konsiderohet kultivar rezistent ndaj sëmundjeve.

Përdorimi:

Kryesisht për konsum të freskët, por edhe për përpunim e tharje.



Kultivarët e kumbullës

Kumbulla Shëngjine

Përhapja: Gjendet e përhapur kryesisht në Shqipërinë e mesme, Tiranë, Krujë, Elbasan, por edhe më gjerë.

Përshkrimi:

Pema ka rritje të fuqishme, me degë që rriten drejt. Gjethja është e madhe, me formë ovale ngjyrë të gjelbër të errët. Lulja është e vogël dhe me ngjyrë të bardhë. Frutat janë të mëdhenj, me formë të rrumbullakët, me cipë me ngjyrë të gjelbër në të verdhë. Bishti është me gjatësi mesatare, i hollë. Tuli është me ngjyrë të gjelbër, shumë i lëngshëm. Bërthama është mesatare, e rrumbullakët dhe nuk shpëputet lehtësisht nga fryti.

Karakteristikat të tjera:

Është kultivar diploid, me prodhime të bollshme të përvitshme. Lulëzon në kushtet e Shqipërisë së mesme javën e parë të Marsit. Frutat piqen në fund të Majit, fillim i qershorit. Janë të qëndrueshëm në vjelje dhe transport. Është rezistent ndaj Sharkës (*Plum Pox Potyvirus*).

Përdorimi:

Për konsum të freskët.



Kumbulla Tropojane

Përhapja: Gjendet e përhapur në Shqipërinë e Veriut, emërtohet shpesh kumbulla e Hasit.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare, me degë që rriten drejt. Gjethja është e madhe me formë eliptike. Lulja është e bardhë. Frutat janë të mëdhenj, me formë ovale, me cipë me ngjyrë vjollcë në blu. Tuli është me ngjyre të verdhë, shumë i lëngshëm dhe shumë i ëmbël, me aromë. Bërthama është e madhe, me formë eliptike me majë dhe që shpëputet lehtësisht nga fryti.

Karakteristikat të tjera:

Është kultivar diploid, me prodhime të bollshme të përvitshme. Lulëzon në kushtet e Shqipërisë së veriut në mesin e Prillit. Frutat piqen në fillim të tetorit. I ndjeshëm ndaj Sharkës (*Plum Pox Potyvirus*).

Përdorimi:

Për konsum të freskët, për prodhim alkooli, lëngje, reçel dhe për tharje.



Kumbulla Vardare e verdhë

Përhapja: Gjendet e përhapur kryesisht në Shqipërinë e mesme (Tiranë, Krujë, Elbasan, Librazhd etj)

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare, me kurorë piramidale, me degë që kanë tendencë rritjeje drejt lart, paksa të përkulura. Gjethja është e madhe, me formë eliptike të zgjatur, me majë të hollë e shumë të shkurtër me një kënd të ngushtë. Gjerësia më e madhe e gjethes është në afërsi të majës së gjethes. Gjethja është e përkulur nga sipër duke krijuar një si ulluk. Lulja është e vogël dhe me ngjyrë të bardhë. Fryti është në formë vezake dhe shpesh simetrik. Lëkura e frytit është e hollë me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, pothuajse uniforme në të gjithë sipërfaqen e frytit. Tuli është me ngjyrë të verdhë, shumë i lëngshëm me teksturë jashtëzakonisht fine, shumë i shijshëm në ngrënie. Bërthama është mesatare, me formë ovale dhe që veçohet lehtë nga tuli. Bishti është me gjatësi dhe trashësi mesatare.

Karakteristikat te tjera:

Kultivar shumë prodhues, piqet në 10 ditorin e tretë të muajit Korrik, ka qëndrueshmëri të lartë ndaj sëmundjes së Sharkës.

Përdorimi:

Për përpunim (prodhim distilati), por edhe për konsum të freskët.



Kumbulla Vlonjate

Përhapja: Gjendet e përhapur në Shqipërinë jugore kryesisht në Vlorë.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare. Degëzat e rendit te dyte dhe trete kane tendence rritje te përkulur, duke i dhënë kurorës forme globoze. Gjethja është e madhe dhe forme eliptike. Lulja e vogël dhe me ngjyrë të bardhë. Fryti është i vogël me formë ovale. Lëkura e frytit ka ngjyrë rozë me shumë pruinë. Ngjyra e tulit e verdhë, e ëmbël dhe shumë e shijshme. Bishti i frytit i fiksuar shumë mirë me frytin. Bërthama e vogël, me formë ovale dhe veçohet lehtë nga fryti. Frutat piqen në fillim të muajit Gusht.

Karakteristikat të tjera:

Kultivar me prodhimtari të lartë dhe të përvitshme. Frutat piqen në fillim të muajit Gusht. Fruta janë shumë të shijshëm dhe me pamje atraktive, me qëndrueshmëri të lartë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Përdorimi:

Për konsum të freskët.



Kumbulla Pistilka

Përhapja: Gjendet kryesisht në pjesën qendrore të vendit.

Përshkrimi:

Pema ka rritje mesatare në të fuqishme, me degë mesatarisht të fuqishme me tendencë rritje drejt. Gjethet janë me formë vezake, të trasha. Lulja është e vogël me ngjyrë të bardhë. Fryti është i vogël, vezak, me ngjyrë të verdhë të lehtë. Tuli është me ngjyrë jeshile, shumë i lëngshëm, me shije të veçantë. Bishti është i shkurtër në mesatar, i ngjitur dobët në fryt. Bërthama është e madhe, vezake dhe me majë.

Karakteristika të tjera:

Ky kultivar është shumë prodhues. Lulëzon në fund të Marsit. Frutat piqen në qershor. Nuk është i qëndrueshëm në transport. Preket pak nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Përdorimi: Për përpunim.



Fiku: “Kraps”

Specia: *Ficus carica* L

Përhapja: Në Shqipërinë e mesme, në zonën e Tiranës

Në Shqipërinë e mesme, në zonën e Tiranës.

Varietet shume i vjeter, dy heresh.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit e zezë,

Forma e frutit pllocake,

Ngjyra e tulit kafe ne roze.

Shija e frutit e ëmbël, ne pjekjen e pare aromatike
në të ëmbël dhe ne pjekjen e dyte e ëmbël.

Koha e pjekjes fundi i Qershorit dhe pjekja e dyte
15 diteshi i dyte i Gushtit.

Masa e frutit mesatare, ne prodhimin e dyte pak
me e vogël.

Forma e frutit pllocake.

Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të fre-
skët.

Veçoritë:

Varietet prodhues, i qëndrueshëm ndaj
temperaturave të larta dhe thatësisë. Fur-
nizon tregun dy herë në periudhën e verës.



Fiku: “Rotllar”
Specia: *Ficus carica* L

Përhapja:

Në Shqipërinë e Mesme, në zonën e Tiranës.

Varietet i rrallë.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit e zezë,

Forma e frutit ovale.

Ngjyra e tulit e kuqe.

Shija e frutit karamel.

Koha e pjekjes nga 20 Gushti.

Masa e frutit mesatare.

Forma e frutit ovale.

Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Lëkura e frutit e shndritshme dhe ngjyra e tulit e kuqe si në vishnje.



Fiku: “Allaxhir”
Specia: *Ficus carica* L

Përhapja:

Në Shqipërinë e Mesme, kryesisht në zonën e Tiranës. Është varietet i rrallë.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit jeshile në violet
Ngjyra e tulit kafe e celet në roze.
Shija e frutit neutrale.
Koha e pjekjes pas 15 Gushtit.
Masa e frutit e vogël.
Forma e frutit sferike.



Përdorimi

Frut me destinacion për konsum të freskët.
Prodhon një herë.

Veçoritë

Varietet i rrallë, jo
i përhapur.



Fiku : “Cipull”

Specia: *Ficus carica* L

Përhapja: I përhapur kryesisht në Shqipërinë e mesme dhe të jugut.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit jeshile e errët.

Forma e frutit konike.

Ngjyra e tulit e kuqe e errët.

Shija e frutit pak e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 15 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.

Forma e frutit konike.



Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Është varietetet prodhues. Në Shqipërinë e jugut gjendet me ngjyrë të zezë, kurse në Shqipërinë e Mesme me ngjyrë jeshile të errët e me disa njolla të vogla kafe.



Fiku:” Tivaras”

Specia: *Ficus carica* L

Përhapja: E përhapur ne zonën e Shqipërisë veripërendimore.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit jeshile e celet.

Forma e frutit konike..

Ngjyra e tulit kafe e celet ne te kuqe..

Shija e frutit e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 10 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.



Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë

Varietet i përhapur në zonën e Shkodrës dhe mbi Shkodrës si dhe në rajonin kufi kesaj zone, ne Malin e Zi.



Color fruit is wite green
Internal fruit is light brown
Size fruit is medium
Flavour fruit is honey
Maturity is 1-20 September
Productivity is iniffer
Destination for fresh consum

Fiku: “Patëllxhan”

Specia: *Ficus carica L*

Përhapja: Varietet i përhapur në Shqipërinë veri përëndimore dhe në atë të mesme dhe të jugut.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit violet ne patllixhan..

Forma e frutit patllixhan.

Ngjyra e tulit e kuqe errët.

Shija e frutit e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 11 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.

Forma e frutit patellxhan.



Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçantitë:

Ky varietet është i përhapur kryesisht në zonën e Shkodrës, por është përhapur dhe në Shqipërinë e mesme dhe atë të jugut, por në forma pak më të ndryshme.



Fiku Melacak

Specia: *Ficus carica L*

Përhapja:

Varietet i përhapur në Shqipërinë e Mesme dhe atë veripërëndimore.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është bakër.

Ngjyra e tulit e kuqe.

Shija e frutit e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 11 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.

Forma e frutit në formë dardhe.



Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët dhe për tharje.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Varietet për tharje.



Fiku :”Stambolli”
Specia: *Ficus carica L*

Përhapja: Varietet i përhapur në Shqipërinë e jugut, i përqendruar në një rajon.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është jeshile.

Forma e frutit sferike.

Ngjyra e tulit e kuqe.

Shija e frutit neutrale.

Koha e pjekjes pas 25 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.

Forma e frutit sferike.



Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Ky varietet është i përhapur kryesisht në zonën e Beratit. Varietet i introduktuar por i përshtatur shumë mirë në këtë zonë.



Fiku “Roshnik”

Specia: *Ficus carica* L

Përhapja: Varietet i përhapur ne gjithë vendin, por është tipik i zonës se Beratit.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është jeshile.

Forma e frutit sferike.

Ngjyra e tulit e kuqe.

Shija e frutit neutrale.

Koha e pjekjes pas 25 Gushtit.

Masa e frutit mesatare.

Përdorimi:


Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.



Veçoritë

Varietet me destinacion për tharje, i vetmi varietet qe eksportohet si i thate.



Fiku: “Tragjas”
Specia: *Ficus carica L*

Përhapja: Varietetet i përhapur kryesisht në zonën e Vlorës

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është e zezë
Forma e frutit sferike.
Ngjyra e tulit është roze.
Shija e frutit është e ëmbël.
Koha e pjekjes pas 10 Gushtit.
Masa e frutit mesatare.

Përdorimi:

Frut me destinacion për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Varietete lokal i përhapur në një rajon të jugut.



Fiku “Perdhikul”

Specia: *Ficus carica L*

Përhapja: Varietet i përhapur në Shqipërinë e jugut.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është jeshile në të verdhë.

Forma e frutit sferike në plloçake.

Ngjyra e tulit është e kuqe e errët.

Shija e frutit është e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 10 Gushtit.

Masa e frutit e vogël.

Forma e frutit sferike në plloçake.

Përdorimi:

Frut me destinacion për tharje.

Prodhon një herë.

Veçoritë:

Varietet i lokalizuar vetëm në rajonin e jugut, karakteristike thahet në pemë, në zonën tipike quhet çepele.



Fiku: “Cingell”
Specia: *Ficus carica* L

Përhapja: Varietet i përhapur në shumë zona të vendit.

Përshkrimi:

Ngjyra e frutit është jeshile.

Forma e frutit sferike.

Ngjyra e tulit është e kuqe.

Shija e frutit është e ëmbël.

Koha e pjekjes pas 15 20 Shtatorit.

Masa e frutit e vogël në mesatare.



Përdorimi:

Frut me destinacion
për konsum të freskët.

Prodhon një herë.

Veçoritë: Varietet i lo-
kalizuar vetëm në ra-
jonin e jugut, varietet
rezistente ndaj tem-
peraturave të ulta dhe
me pjekje të vonë.



Shega Devedishe

Specia: *Punica Granatum* L

Përhapja: Në Shqipërinë veriperëndimore, kryesisht në Shkodër. Varietet karakteristik i zonës që shtrihet edhe pjesën e Malit të zi.

Përshkrimi:

Fryti rrumbullaket, me ngjyrë të verdhe ne roze, pesha e mesatare nga 300 deri ne 800 g. Lëkura e trashë. Farat me ngjyre roze. Ato përmbajnë deri ne 20% sheqer, janë me shije dhe shume të ëmbël.

Prodhimtari e lartë, e qëndrueshme. Piqet fundi i Shtatorit – Tetor.



Përdorimi:

Përdoret për konsum te freskët dhe shurup.



Shega Tivarash

Specia: *Punica Granatum L*

Përhapja: Përhapur ne Shqipërinë veriperëndimore dhe ne Malësinë e Madhe

Përshkrimi:

Fryti me ngjyrë të gjelbër me njolla te kuqe, cipa e holle, forma e rrumbullaket, kokrrizat me ngjyrë të kuqe ne vishnje, pesha e frytit shkon nga 200 deri ne 800 g. Përmbajtja e sheqerit shkon deri ne 15-17%. Prodhimtari e larte, e qëndrueshme. Piqet fundi muajit Shtator - Tetor.



Përdorimi:

Përdoret për konsum te freskët dhe për industri.

Veçoritë: Karakteristike është ngjyra vishnje e arielit, me shume lëng.



Shega Majhoshe

Specia: *Punica Granatum L*

Përhapja: Është e përhapur ne Shqipërinë e jugut.

Përshkrimi:

Fryti me ngjyrë të kuqe në të verdhë, kokrrizat me ngjyrë të kuqe deri në të kuqe të errët. Fryti me peshe mesatare nga 300 g deri ne 500 g. Ka shije të mirë dhe ëmbëlsi që shkon deri 18-19% sheqer. Me prodhimtari të lartë deri në 120 kokrra për bime. Piqet në vjeshtë, Shtator – Tetor.



Përdorimi

Perdoret per konsum te fresket.

Veçoritë: Karakteristike e zonës së jugut, shega me lekurë të shndritshme dhe me tregues cilesor shumë të mirë.



Hide vendit
Specia: *Ziziphus jujube*

Përhapja: Përhapur ne Shqipërinë e Mesme, por vitet e fundit ka gjetur përhapje edhe më të gjerë.

Përshkrimi:

Peme me prodhimtari te larte. Futi me ngjyre kafe në vishnje, madhësi mesatare, forte, lëkura e shtrire dhe e shkëlqyer, shija mesatarisht e ëmbël, piqet ne Shtator.



Përdorimi:

Për konsum te freskët. Frutë qe konsumohet me shume për fëmijët. Vitet e fundit janë shtuar dhe forma idesh te tjera.



Mani i bardhë

Specia: *Morus alba*

Përhapja:

Është i përhapur ne Shqipërinë e Mesme, por edhe ne makro dhe mikrozona te tjera te vendit.

Përshkrimi:

Peme me prodhimtari te larte, kurore te hapur. Futi me ngjyrë të bardhe, i bute, shume i ëmbël, % e sheqerit shkon deri 20%. Piqet ne periudhën e pranverës, ne fillimin e pjekjes se frutave verore.



Përdorimi:

Përdoret për frutë dhe industrinë përpunuese.



Nespula verore
Specia: *Eriobotrya japonica*

Përhapja: Është me origjinë nga Japonia. Gjendet e kultivuar në Shqipëri në Mesme dhe atë të jugut, kryesisht në kopshtet familjare.



Përshkrimi :

Fryti me ngjyre portokall, me formë dardhe dhe madësi mesatare. Ata janë me shijë të mirë e të ëmbël. Numri i farave në fryt 2. Farat në këtë varietet janë me të mëdha dhe me ngjyrë kafe. Peme me produktivitet. Frutat piqet në Maj .

Përdorimi:

Përdoret si fryt i freskët dhe si peme dekorative.

Ulliri Mixan

Përhapja: Varieteti njihet dhe me emërtime si: Mixa dhe Vajsi Peqinit. Është i përhapur kryesisht në Shqipërinë e mesme, në zonat Peqin, Elbasan dhe Tiranë.



Përshkrimi:

Pema ka fuqi mesatare, kurorë gjysëm të varur, degë dhe degëza të mbledhura e të dëndura. Me ndëryje të shkurtëra. Gjethja ka formë eliptike me gjatësi të shkurtër dhe të ngushtë, profil të rrafshtë e ngjyrë jeshile të zbehtë. Sipërfaqe gjethore të vogël.



Lulëria është kranth i shkurtër. Numuri i luleve i ulët, me strukturë kompakte dhe të shkurtër. Formë panikul. Fruti ka ngjyrë të kuqe të verës. Formë ellipsoidal elehtësisht asimetric.



Kultivimi:

Kultivar me rendiment të lartë, jep prodhim mesatar-periodik. Paraqet aftësi rrënjëzimi të lartë.

Pjekja: e vonët, Dhjetor, e shkallëzuar.



Veçoritë:

Varieteti ka rezistencë mesatare ndaj dëmtuesve *Cycloconium oleaginum* dhe *Bractocera oleae*. Gjithashtu është rezistent ndaj të ftohtit dhe ndaj thatësirës.



Përdorimi: Vaj, përmbajtje të lartë vaji.

Ulliri i holl i Himarës

Përhapja

Varieteti njihet edhe me sinonimet Nisjot, Himara dhe Nisjot bregu. Është i përhapur në jug të Shqipërisë, në zonën e Himarës nga merr edhe emrin. Kryesisht është i lokalizuar në bregdetin e Vlorës (Himarë, Vuno).



Përshkrimi

Pema paraqitet e fuqishme, ka kurorë me degë të hapura. Degët sekondare dhe degëzat veshëse janë shumë të dendura e të varura, me ndërnyje mesatare. Gjethja ka formë eliptike me përkulshmëri, të përdredhura. Nervaturë e gjatë-mesatare e gjërënë ngjyrëjeshile-bronxi. Sipërfaqja gjethore mesatarisht e madhe.



Lulëria është kranth mesatar i gjatë. Numuri i luleve në kranth mesatar, me strukturë të gjatë e të rrallë. Formë panikul, me mbi 3 degëzime.



Fruti ka ngjyrë vere-violet me formë elipsoidale, lehtësisht asimetrik.



Kultivimi

Varietet me rendiment të lartë, prodhim mesatar-konstant. Ka vajtë cilësisë së lartë. Paraqet aftësi rrënjëzimi të ulët.

Pjekja: Dhjetor.e vonëshme, e shkallëzuar. Varietet shumë rentabël.



Veçoritë

Varieteti është rezistent ndaj *Cycloconium oleaginum*, mesatar ndaj *Bractocera oleaes*. Rezistent ndaj të ftohtit dhe ndaj thatësires. Paraqitet i ndjeshëm ndaj *Pseudomonas*. Vaji ka shije organoleptike shumë të mirë.

Përdorimi: Vaj, përmbajtje e ulët vaji.

Pulazeqin

Përhapja

Varieteti njihet edhe me sinonimet Pulez dhe Pulazequine. Është një varietet i vjetër, me orgjinë në zonën e Vlorës, por i përhapur në zona të ndryshme si; Vlorë, Himarë, Sarandë, Delvinë dhe Mallakaster. Ai është i përhapur kudo ku kultivohet cv.Kaninjot.



Përshkrimi

Pema ka zhvillim shumë të fuqishëm. Kurorë polikonike me degë në kënde të gjëra e degëza të varura gati të dendura, me dërnyje të shkurtëra.



Gjethja eliptike-shtizë e rafshtë, ka gjatësi dhe gjërësi mesatare. Nervaturë gjatësore të rafshtë me ngjyrë jeshile të fortë. Sipërfaqja është pothuaj mesatare.



Lulëria është kranth mesatarisht i gjatë. Numur i luleve për kranth është mesatar dhe me srukturë të gjatë dhe të rrallë. Forma panikul, paraqitet me mbi 3 degëzime.



Fruti ka ngjyrë të zezë-violet, me formë vezake pak simetrik, me peshë të vogël.

Kultivimi

Varietet paraqitet me prodhimtari të lartë e me prodhim konstant. Ka aftësi rrënjëzimi të ulët dhe futet shpejt në prodhim pas mbjelljes.



Pjekja: Dhjetor, pjekje e njëkohëshme dhe e herëshme.

Veçoritë: Rezistent ndaj *Cycloconium oleaginum*, por është indjeshëm ndaj *Pseudomonas* dhe *Bractocera oleae*. Paraqitet rezistent ndaj të ftohtit, thatësisirës dhe tokave gëlqerore.

Përdorimi: Vaj. Ka përmbajtje të ulët vaji.

Kotruvs

Përhapja

Varietet i përhapur gjerësisht në zonën e Beratit, por edhe në Patos dhe Mallakastër.

Përshkrimi

Pemë e fuqishme, me kurorë globoze e degë të shtrira. Ka degëza të dendura dhe të varura, me ndërnjye mesatare.

Gjethja ka formë eliptike, të përkulur në dy anët me gjatësi mesatare e të ngushta. Nervatura gjatësore e rrafshët me ngjyrë jeshile të fortë në faqen e sipërme. Sipërfaqja gjethore mesatare.

Lulëria është kranth me gjatësi mesatare. Numri i lulëve/kranth është mesatar. Lulet janë të vogla në ngjyrë të bardha. Kranthi ka strukturë kompakte dhe i shkurtër. Paraqitet me formë panikul.

Fruti ka ngjyrë të kuqe të verës. Paraqitet në formë vezake me majë, subkonik e simetrik dhe kapeshë mesatare.

Kultivimi

Varietet me rendiment të lartë dhe prodhim lehtësisht konstant. Ka aftësi rrënjëzimi mesatare.

Pjekja: Nëntor-Dhjetor.

Veçoritë

Varieteti paraqitet ndjeshëm ndaj *Cycloconium oleaginum*, tolerant ndaj *Pseudomonas sevastanoi* dhe i ndjeshëm ndaj *Bractocera oleae*. Gjithashtu paraqet rezistencë ndaj të ftohtit dhe thatësirës.

Përdorimi: Për vaj.



I Bardhi Krujës

Përhapja

Ulli me orgjinë nga zona e Krujës. Popullatë mesatarisht e madhe. I përhapur kryesisht në Krujë deri në Lezhë.

Përshkrimi

Pema paraqitet me zhvillim mesatar. Ka degë skellore në kënde të gjëra, me degëza të dendura pak të varura dhe ndërrnyje të shkurtëra.

Gjethjaka formë eliptike, mesatare në gjatësi, me gjerësi të ngushtë. Nervatura gjatësore e rafshtë, në ngjyrë jeshil të hapur hiri.

Lulëria: Kranthi i shkurtër me numër lulesh për kranth të ulët. Paraqitet kompakt i shkurtër, por në formë vilë e çregullt.

Fruti: Epikarp të zi me tul të bardhë. Ka formë ovale asimetrike me peshë mesatare.

Kultivimi



Paraqitet me rendiment mesatar dhe me prodhim periodik. Ka cilesi të lartë vaji, si edhe përmbajtje të lartë. Rekomandohet si i përshtatshëm për dendësi të mëdha bimësh dhe ka aftësi rrenjezimi të lartë.

Pjekja: e vontë, Dhjetor.

Veçoritë

Paraqitet i ndjeshëm ndaj *Cycloconium*, por tolerant ndaj *Bractocera oleae*. Rezistent ndaj të ftohtit, thatësirës dhe gëlqerës.

Përdorimi: Vaj.



Kryps Berati

Përhapja

Varietetet njihet edhe me sinonime si Kokër madh Berati, por dhe Kokër madhi Vlonjat. Eshtë varietetet me orgjinë prej zonës së Beratit, por i perhapur dhe në zona të tjera si në Lushnjë, Patos dhe Mallakastër.

Përshkrimi

Pemë me zhvillim të fuqishëm, me kurorë me degë në kënde tëhapura. Zotëron degëza tëfuqishme, të dendura e të varura. Kurora ka formë kupore globoze.

Gjethjaka formë eliptike, e gjërë dhe e përdredhur me ngjyrë jeshile tëfortë. Ka sipërfaqe relativisht të madhe.

Lulëria: Kranthi i gjatë Lulet janë të mëdhanë ngjyrëtë verdha në të bardhë.

Fruti është me formëovale, i gjatëdhe simetrik.

Pjekja e hershme dhe e shkallëzuar. Ka përmbajtje të ulët vaji.

Kultivimi

Kultivar me prodhimtari të lartë dhe tëpërvitëshme. Hyn shpejt në prodhim pas mbjelljes, por karakterizohet nga perqindje e ulët rrënjëzimi.

Pjekja: Mesatarisht e hereshme (Nëntor).

Veçoritë

Kultivar me qëndrueshmëri mesatare ndaj *Pseudomonas*. Paraqet ndjeshmëri ndaj *Cycloconium* dhe *Bractocera*.

Përdorimi: Tryezë.



Kryps Elbasani


Përhapja

Ky varietet njihet dhe me sinonimet Kokër madh Elbasani dhe Kryps. Është varietet me orgjinë prej zonës së Elbasanit, por i përhapur dhe në zona të tjera si në Peqin, Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Tiranë.



Përshkrimi

Pemaparaqitet mesatarisht e fuqishme, me kurorëpoplikonike, degë dhe degëza mesatarisht të dendur me pozicion vertikal.



Gjethja ka formë eliptike, me përkulshmëri në dy anë dhe e përdredhur. Gjethet janë të gjata dhe gjërësi mesatare. Nervatura gjatësore e rrafshtë e përdredhurështë në ngjyrë jeshile të hirtë.



Lulëria: Kranthi ka gjatësi mesatare me numër lulesh në kranth mesatar deri i madh. Paraqitet në strukturë kompakt, i gjatë dhe me formë penikul.

Fruti paraqitet i zi-violet, me formë sferik-oval, simetrik dhe me peshë mesatare.



Kultivimi

Paraqitet si kultivar me rendiment të lartë, që ka prodhim periodik e tregues të ulët rentabiliteti. Hyn mesatarisht vonë në prodhim.



Pjekje: Mesatare e herëshme (Nëntor).

Veçoritë

Shumë i ndjeshëm ndaj *Cycloconium oleaginum* dhe *Bractocera oleae*. Rezistent ndaj të ftohtit dhe ndaj gëlqeres.

Përdorim: Ka përdorim të dyfishtë.

Kaninjot

Përhapja

Varieteti njihet edhe me sinonimet Kalinjot dhe ulli Kanine. Është varietet me orgjinë nga zona e Vlorës, por i përhapur edhe në zona të tjera, si Sarandë, Delvinë, Mallakastër, Fier, Lushnjë, etj.

Përshkrimi

Pema ka zhvillim të fuqishëm, me kurorë me degë të hapura, anësore dhe vertikale. Degëzat janë të fuqishme e të dendura. Kurora ka formë konike në poli konike. Disa forma kanë tendencë vertikale. Gjethja ka formë eliptike të gjata e të gjëra dhe kanë ngjyrë jeshile të hapur në faqen e sipërme dhe të hirtë-argjendi në faqen e poshtme. Sipërfaqe gjethore relativisht mesatare.

Lulëria: Lulëzimi është bollshëm, me lulet që hapen në javën e tretë të muajit Maj. Kranthi është gjatëme numër mesatar lulesh. Fruti ka formë sferike-lehtësisht oval, me gjatësi mesatare.

Pjekja: Dhjetor, ka pjekje të vonëshme dhe të shkallëzuar.



Kultivimi

Varieteti paraqitet me prodhimperiodik dhe aftësi maksimale rrënjëzimi. Megjithatë futet vonë në prodhim pas mbjelljes, jep rendiment të lartë vaji dhe të një cilësie maksimale.

Veçoritë

Kultivar me qëndrueshmëri ndaj të ftohtit, por i ndjeshëm ndaj *Pseudomonas* dhe *Cycloconium*. Gjithashtu ka ndjeshmëri mesatare ndaj *Bractoceras*.

Përdorimi: Përdorim të dyfishtë.



I Bardhi Tiranës

Përhapja

Varieteti njihet edhe me sinonimin Karren dhe është me orgjinë në zonën e Tiranës.

Përshkrimi

Pema ka zhvillim mesatarisht të fuqishëm, dhe kurorë voluminoze, me degë dhe degëza të dendura, gjysëm të varura e ndërnije të shkurtëra.

Gjethja ka formë eliptike me gjatësi të shkurtër e gjërsi të ngushtë. Nervatura gjatësore e rafshtë në ngjyrë jeshile-hiri në faqen e sipërme. Gjethja ka sipërfaqe të vogël.

Lulëria: Kranthi është i shkurtër me një numër lulësh të ulët. Ka strukturë kompakte, por duket i shkurtër me formë vilë të çregullt.

Fruti, bërthokël me epikarp të zi, me tul të bardhë. Ka formë vezake, si dardhë, pak asimetrik. Ka peshë dhe gjatësi mesatare.

Pjekja: Paraqitet mepjekje të vonëshme dhe të shkallëzuar.

Kultivimi

Varietet paraqitet me rendiment dhe cilësi të lartë vaji, por ka prodhim të theksuar periodik. Kapacitet të lartë rrënjëzimi, por futet vonë në prodhim pas mbjelljes.

Veçoritë

Duket varietet shumë i ndjeshëm ndaj *Cycloconium oleaginum*, por rezistent ndaj *Bractocera oleae*. Rezistent ndaj të ftohtit, ndaj thatësirës, si dhe gëlqeres.

Përdorimi: I dyfishtë, për vaj dhe tavolinë.



Krypsi i Krujës

Përhapja

Varieteti është me orgjinë në zonën e Krujës.

Përshkrimi

Pema paraqitet me një fuqi mesatare zhvillimi. Ka kurore polikonike, me degë dhe degëza të shumta e të rralla. Ndërnyjet kanë përmasa mesatare.

Gjethja ka formë eliptike, tëzgjatur dhe të gjërë. Nervatura gjatësore është drejtënë të përdredhur, me ngjyre jeshile të forte hiri gjithmonë në faqen e sipërme.

Lulja: Kranthi që ka përmasa mesatare është kompakt dhe i shkurtër dhe ka numër të vogël lulesh për kranth. Formë penikul espiciform.

Fruti: Fruti ka bërthokël me epikarp të zi-violet dhe tul të kuq vere. Formë vezako-sferik, lehtësisht simetrik. Ka peshë mesatare dhe gjatësi të shkurtër deri mesatar.

Pjekja: Mesatare e herëshme.

Kultivimi

Varieteti paraqitet me prodhim kostant, futet herët në prodhim dhe ka një aftësi rrënjëzimi mesatare.

Veçoritë

Duket me rezistence mesatare ndaj *Cycloconium* dhe *Bractocera oleae*, si dhe është rezistent ndaj të ftohtit.

Përdorimi: I dyfishtë, tryezë dhe vaj.



Ulliri Boç

Përhapja

Varieteti është me orgjinë në zonën e Tiranës; përhapur kryesisht në pjesën lindore të saj.

Përshkrimi

Pema paraqitet mesatarisht e fuqishme në zhvillim. Ka kurore kupore mesatare dhe degë skeletore me kënde të ngushta dhe ndërnyje mesatare.

Gjethja ka formë eliptike, në formë të zgjatur dhe të gjëra mesatarisht. Nervatura gjatësore është e drejtë në të përdredhur, me ngjyre jeshile gri, në faqen e sipërme.

Lulja: Kranthi me përmasa mesatare; ai është në formë vile të çrregullt.

Fruti: Fruti ka epikarp në ngjyrë të zi dhe tul vjollcë. Formë ovalo-sferik, lehtësisht simetrik. Ka peshë mesatare dhe gjatësi të shkurtër deri mesatar.

Pjekja: Mesatarisht e vonëshme e shkallëzuar.

Kultivimi

Varieteti është shumë prodhues, por me prodhim periodik. Futet herët në prodhim dhe ka një aftësi mesatare rrënjëzimi.

Veçoritë

Është i ndjeshëm ndaj dëmtuesve *Cycloconium* dhe *Bractoceras*, por rezistent ndaj *Pseudomonas*, si dhe paraqet rezistence ndaj të ftohtit.

Përdorimi: I dyfishtë, për tryezë dhe vaj.



Ulliri Bllanic

Përhapja

Varieteti është me orgjinë në zonën e Vlorës; i përhapur kryesisht në rrethinat e lumit të Vlorës.

Përshkrimi

Pema paraqitet me një fuqi mesatare zhvillimi. Ka kurore kupore globoze të dendur, me drunë me korde të shumta e degëza të varura me ndëryje të shkurtera.

Gjethja ka formë eliptike shtizë, të gjata dhe gjerësi të ngushtë. Nervatura gjatësore është e drejtë epanistike, me ngjyre jeshile gri gjithmonë në faqen e sipërme.

Lulja: Kranthi që ka përmasa mesatare është kompakt; ka numër mesatar lulesh për kranth. Forma e tij duket penikul.

Fruti: Fruti është gati i gjatë me ngjyrë lejla në vjollcë. Ka bërthokël me epikarp me tul ngjyrë të kuqe vere. Formë oval, me majë konike, lehtësisht simetrik.

Pjekja: Shumë e herëshme, e njëkohëshme.

Kultivimi

Varieteti është mjaft i përshtatur për ullishte intensive. Hyn menjëherë në prodhim. Paraqitet me prodhim konstant dhe kapacitet rrënjëzimi të ulët.

Veçoritë

Duket i ndjeshëm ndaj dëmtuesve *Cycloconium* dhe *Bractoceras*, por rezistent ndaj *Pseudomonas*, si dhe paraqet rezistence ndaj thatësirës.

Përdorimi: I përshtatshëm për vaj.



Ulliri Cerje

Përhapja

Varieteti njihet gjithashtu me emrin Vërdhac dhe është me orgjinë në zonën e Vlorës; i përhapur kryesisht buzë lumit të Vlorës.

Përshkrimi

Pema paraqitet e fuqishme, me kurorë kupore globoze të rrallë, degë skeletore dhe veshëse të dendura. Ndernyje mesatare-gjata me një fuqi mesatare zhvillimi.

Gjethja ka formë eliptike, me majë dhe bazë rrethore, pjesërisht e përdredhur dhe me gjatësi e gjerësi mesatare. Nervatura gjatësore është e drejtë, e përdredhur me ngjyrë jeshile të shndritshme në faqen e sipërme.

Lulja: Kranthi ka strukturë të rrallë, i gjatë dhe me numër të vogël e deri mesatar lulesh për kranth. Forma e tij duket penikul.

Fruti: Fruti mesatarisht i gjatë, ka bërthokël me epikarp të kuq të verdhë dhe pulpë rozë. Forma është ovale simetrike.

Pjekja: Mesatarisht e herëshme, e njëkohëshme.

Kultivimi

Varieteti paraqitet me prodhim lehtësisht konstant; futet herët në prodhim dhe ka një aftësi mesatare rrënjëzimi.

Veçoritë

Duket i ndjeshëm ndaj *Cycloconium*, deri në shumë i ndjeshëm ndaj *Bractoceras* dhe *Sevastanoit*. Paraqet rezistencë ndaj të ftohtit.

Përdorimi: Ka përdorim të dyfishtë, tryezë dhe vaj. Përmbajta e vajit në frut është mesatare.



Ulliri Kçarr

Përhapja

Është me orgjinë nga fshatrat e Malësisë së Madhe, kryesisht i përhapur në zonat e malit.

Përshkrimi

Pema paraqitet shumë e fuqishme, me kurorë polikonike voluminoze, degë skeletore me kënde të gjëra e ndërrnyje mesatare.

Gjethja kaformë eliptike, me gjatësi e gjerësi mesatare. Nervatura gjatësore është e rrafshët me ngjyrë jeshile në gri në faqen e sipërme.

Lulja: Kranthi ka strukturë të rrallë, i gjatë dhe me numër të vogël lulesh për kranth. Forma e tij duket panikul.

Fruti: Fruti mesatar, bërthokël me epikarp të kuq uthulle dhe pulpë të bardhë në rozë. Forma është ovale shumë simetrike.

Pjekja: Mesatarisht e herëshme, e njëkohëshme.

Kultivimi

Varietet shumë cilësor paraqitet me prodhim kostant dhe ka një aftësi rrënjëzimi të lartë. Hyn shpejt në prodhim; me interes për të ardhmen.

Veçoritë

Në drejtim të dëmtuesve duket i ndjeshëm vetën ndaj *Bractoceras*, pra rezistent ndaj *Cycloconium* dhe *Pseudomonas*. Paraqet rezistencë edhe ndaj të ftohtit e thatësisirës.

Përdorimi: Ka përdorim të dyfishtë, për tryezë dhe vaj. Përmbajta e vajit në frut është mesatare.



Sherbela

Salvia officinalis L.

Përhapja: Ka origjinë nga Mesdheu lindor dhe është përhapur në të gjithë Mesdheun; në Shqipëri gjendet me shumicë në të gjithë zonën kodrinore bregdetare dhe më thellë (Malësi e Madhe kryesisht në Koplik, Lezhë, Mat, Rrëshen, Krujë etj). Shkon deri në lartësinë 1000m mbi nivelin e detit.

Përshkrimi: Është me kërcell katërkëndor të degëzuar deri rreth 80-100cm të lartë. Gjethet janë të forta e me një veshje pushore të bardhë, me formë vezake gjatoshë dhe vendosje të përkundërt. Lulet, me ngjyrë blu në manushaqe, ndonjëherë në trëndafili, formojnë kallinj fundorë; kupa, si kampanë dybuzore, është leshtore e me nervura të shumta. Bima ka aromë të këndshme dhe shije të hidhur aromatike.

Shtimi: Kryhet me farë si dhe nëpërmjet copave rrënjore ose duke mbjellë copat e bimës.

Përdorimi: Droga mjekësore përbëhet nga gjethet, të cilat përveç qimeve mbuluese, kanë dhe qime të tipit klasik të *Labiataeve*. Acidet yndyrore që gjenden tek sherbela kanë veti antiseptike, antivirale, antimykotike, antioksiduese dhe anti-inflamatore.

Sherbela përdoret si stimulant, në ulcerat, kundër deprsionit, marramendjes etj. Përdoret kundër kollës, ftohjeve dhimbjes së grykës dhe bronkitit. Në kozmetik vaji esencial i sherbelës përdoret si përbërës aromatik i sapunëve, pluhurave dhe lëngjeve larës, kremrave, parfumeve.



Foto: D.Xhulaj (Koplik, Malësi e Madhe)



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)

Lavanda

Lavandula officinalis L.

Përhapja: Është bimë spontane në vendet mesdhetare, por dhe kultivohet mjaft për esencën e saj mjaft të kërkuar. Rritet në toka të drenazuara, jo shumë të pasura me humus dhe pak alkaline. Kërkon diell dhe plehërim të rrallë. Në Shqipëri kultivohet në zonën e Malësisë së Madhe.

Përshkrimi: Bimë aromatike, dendësisht shkurre, me degë të reja barishtore katër këndore; gjethet janë gati të verdha bojë hiri, gjatoshë të holla, me buzë të përveshura e me vendosje të përkundërt. Kërcejtë lulorë nuk kanë gjethë poshtë luleve, por kanë kallinj të gjatë lulorë nga qershori në shtator.

Shtimi: Kryhet me farë si dhe nëpërmjet copave rrënjore ose duke mbjellë copat e bimës.

Përdorimi: Droga mjekësore përbëhet nga lulesat në copa ose në lule; me distilim ekstrahohet esenca e bimës, me aromë të këndshme. Ka veti qetësuese, tonik për sistemin nervor, stimulon qarkullimin e gjakut, antibakterial, antiseptik. Esenca e lavandulës, që është shumë e përdorur në parfumeri, është qetësuese dhe antispazmatike. Përdoret dhe në veterinar. Hibridet e llojeve të përmendura që quhen lavandula, mund të gjenden dhe në kushte natyrore e të përdoren për esenca. Përveç produkteve kozmetike dhe vajit lavanda njihet dhe për mjaltin që shquhet për vlerat ushqyese.



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)



Foto: D. Xhulaj (Valias, Tiranë)

Nenexhiku, mendra

Mentha piperita L.

Përhapja: Bimë me origjinë nga Evropa dhe Azia, prkatikisht mund të rritet gjithkund, e që përhapet gjerësisht dhe në vendin tonë në pyje e kullota.

Përshkrimi: Kjo është një bimë barishtore me stolone, kërcell të drejtë e me ngjyrë të kuqe në manushaqe (nenexhiku i zi), ose të gjelbër (nenexhiku i bardhë), katër këndor e i degëzuar. Ka gjethe të përkundërta, vezake me majë, me dhëmbëzime të parregullta, të shogëta me ngjyrë të blertë të errët e me pak gjëndra. Lulet formojnë kallinj fundorë, kanë kupë të qëndrueshme, kurorë gati të rregullt si kabanë, me katër pjesë pothuaj të njëjta, në ngjyrë manushaqe ose bardhoshe. Meqenëse është një hibrid steril, shumohet vetëm me pjesë vegjetative. Është një specie shumë polimorfe e kultivuar gjithandej edhe në Shqipëri.

Shtimi: Shtohet duke përdorur stolonet me gjatësi jo më pak se 15 cm në vjeshtë ose fillim pranvere por dhe me fara që mbliidhen në fund të verës.

Përdorimi: Nga pjesa vegjetative e sapo mbledhur e *M. piperita* nxirret vaj esencial. Menta me aromë të fortë, shije pikante e që lëshon një freski të këndshme, përdoret si stimulant, tonik, antispazmatik, stomakik, karminativ për rastet e atonisë gastrike, kolike, hepatike e nefritike. Futet si rregullues shijesh në çamçakëza, karamelë, likerna etj. Mentoli hyn në përbërje të lëndëve balsamike bashkë me eukaliptolin, kamforin, esencën e trementinës. Ndihton kundër bllokimeve të frymëmarrjes, sinozitit dhe bllokimeve të krahavarit.



Foto: D. Xhulaj (Koplik, Malësi e Madhe)



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)

Rozmarina

Rosmarinus officinalis L.

Përhapja: Gjendet spontane në bregdetin mesdhetar; tek ne gjendet dhe e kultivuar sidomos në zonën e Malësisë së Madhe.

Përshkrimi : Është një bimë gjithmonë e blertë, e degëzuar deri në 2 m e lartë, me gjethe të holla, të ngushta e lëkurore, të gjelbëra të errëta sipër e bardhoshe nga poshtë. Lulet bojë qielli ose lejla e rrallë të bardha, vendosen në afërsi të majave të degëve.

Shtimi: Mund të shtohet me farë në pranverë por mbirja është e ngadaltë, ndaj preferohet shtimi i bimës me copa.

Përdorimi: Ka veti stimuluese, antispazmatike dhe përdoret në mjekësi për relaksim e muskujeve të aparatit tretës. Çaji i rozamrinës mund të përdoret për të përmirësuar shëndetin e të gjithë trupit. Ka një efekt të fuqishëm antioksidues, anti-inflamator, antibakterial dhe antiseptik. Përdoret në parandalimin e kancerit duke ulur nivelin e radikaleve të lira në trup. Lehtëson simptomat e ftohjes dhe gripit, qetëson irritimet e lëkurës si dhe redukton nivelin e stresit. Gjethet mund të përdoren si erëza.



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)

Makthi

Helichrysium arenarium Mill

Përhapja: Rritet në vende të thata dhe të zbuluara të cilat rrihen nga dielli. Në vendin tonë takohet si në pjesën e Malësisë së Madhe por dhe në Përmet, Këlcyrë, Gjirokastrë etj.

Përshkrimi: Bimë njëvjeçare që arrin lartësinë nga 30 deri në 40 cm. Lulëzon në qershor dhe në korrik, fryt jep në gusht.

Shtimi: Zakonisht në pranverë me anën e copave, mund të bëhet dhe me farë.

Përdorimi: Lulet kanë veti bakterostatike, të nxisin urinimin, prodhimin e tëmthir, veti spazmolitike etj. Droga e kombinuar dhe me pelinin përdoret kundër parazitëve të zorrëve.

Ka një vaj esencial shumë unik në komponentët e tij molekularë. Është vaji i vetëm që përmban të ashtuquajturat de-kitone përbërësit e së cilës njihen për vetitë anti-inflamatore por gjithashtu ka veti të shkëlqyera relaksuese. Vaj terapeutik me veti regjeneruese, anti inflamator, qetësues. Aroma e *Helichrysium* të bën të ndihesh mirë dhe ka një efekt në psikikë që mund të ndihmojë në lirim të emocioneve negative.



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)



Foto: D. Xhulaj (Valias, Tiranë)

Rigoni

Origanum vulgare L

Përhapja: Është mjaft i përhapur në djerrina e buzë shkurretave; në vendin tonë takohet deri në 1800 m mbi nivelin e detit (Has, Kukës, Pukë, Dibër, Shkodër, Vlorë, Sarandë, Mallakastër etj.). Njihen dy forma; *rigoni i kuq*, i përhapur më tepër në Shqipërinë qendrore e veriore i cili quhet ndryshe dhe çaji i malit, dhe tjetri *i bardhë*, i përhapur në jug. Ndryshimi qëndron në ngjyrën e luleve.

Përshkrimi: Një barishte rreth 80cm e lartë, me kërcell të drejtë, shpesh me ngjyrë të kuqërremtë, shumë a pak pushlore, me gjethe të përkundërta, gati pa bisht, të plota; lulet janë të purpurta ose në gjelbëroshe; fryti aken me katër fara; është aromatike e me shije të hidhur.

Shtimi: Kryhet me farë si dhe duke mbjellë copat e bimës.

Përdorimi: Përdoret pjesa e lulesës, që përmban esencën me ngjyrë verdhoshe në të kuqërremtë. Përdoret si stomakik, antispazmatik dhe erëzë gatimi. Gjethet e bimës të njoma dhe të thara, përmbajnë deri në 40 përbërës aktivë mjekësorë. Përdoren si çaj në kurimin e virozave dhe gripit, përmirëson shëndetin e zemrës si një burim i kaliumit. Antioksidantët që gjenden tek rigoni ndihmojnë në uljen e inflamacionit dhe rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Ndhmon në trajtimin e dhimbjeve muskulare.



Foto: D. Xhulaj (Valias, Tiranë)



Foto: D. Xhulaj (Ndërlysaj, Theth)

Barë-bleta

Melissa officinalis L

Përhapja: Është e përhapur në Evropën qendrore, Azinë perëndimore, Afrikën perëndimore etj. Në Shqipëri është shumë e përhapur deri në lartësitë 1500 m mbi nivelin e detit. Gjendet në livadhet e kullotave, në ledhet e arishtave në fshatra, pranë qendrave të banuara..

Përshkrimi: Bimë barishtore shumëvjeçare, rreth 70-80cm, me kërcëz të drejtë e të degëzuar, me gjethe vezake të dhëmbëzuara. Lulet kanë kurorë në fillim verdhoshe e pastaj të bardhë ose me njolla të kuqe e tub lulor të përkulur që grumbullohen në qerthuj sqetullorë. Bari i bletës ka një aromë shpuese limoni dhe shije lehtësisht të hidhur.

Shtimi: Mund të shtohet me farë në pranverë ose në vjeshtë por mbirja është e ngadaltë, ndaj preferohet shtimi i bimës me copa.

Përdorimi: Droga përbëhet nga gjethet, që kanë qime mbuluese dhe qime sekretore të shkurta me kokë; bën pjesë në disa çaja të përzier. Ndiemon në ulje të depresionit dhe stresit, pakëson dhimbjet e kokës, në ulje të temperaturës dhe në një gjumë të rehatshëm. Përdoret gjatë shtatëzanisë për zbutje të ngërçeve si dhe shton përqendrimin.



Foto: D. Xhulaj
(Valias, Tiranë)

Kamomili

Matricaria chamomilla L

Përhapja: Në Shqipëri është e zakonshme në vende me bar, anës rrugëve e sidomos pranë zonave të banuara, deri në zonën nën-malore.

Përshkrimi: Është bimë barishtore njëvjeçare, aromatike, rreth 20-30cm, me kërcell të drejtë e pa qime, shumë e degëzuar, me rrënjë kryesore shumë të zhvilluara. Gjethet dyfish-pendore, me gjethëza të holla e të gjata, kanë vendosje të këmbýera e pa push. Kaptinëzat me diametër rreth 3 cm kanë një shtrat të ngritur si kon e të veshur me brakteza. Në periferi lulet janë llapore e femërore me ngjyrë të bardhë, tri-dhëmbësh; në qendër janë tube, dyseksore e të verdha; fryti është aken i vogël pak i përkulur e pa qime.

Shtimi: Duke përdorur farërat (akenet) të marra nga lulet në fund të verës, përpara shpërndarjes natyrale.

Përdorimi: Droga mjekësore përbëhet nga kaptinat lulore. Grumbullimi i tyre bëhet me duar, duke mbledhur lulet e hapura. Në treg mund të gjendet në formë kaptinash pa bisht, me bishta e mbeturina lulësh dhe në formë lulësh të thara e të pluhurosura. Ka shumë mundësi të abuzohet me materiale të llojeve të tjera si *C. suaveolens*, *Tanacetum parthenium*, e cila ka dhe aromë të këndëshme. Infuzi i luleve të kamomilit është një qetësues nervor, antispazmatik, përdoret në shqetsimet nervore kalimtare, në dhimbjet e stomakut, uterusit, zorrëve etj. Hyn në përbërjen e shumë çajrave të përzier si të senës, kamomilës, etj.



Foto: F.Elezi (Valias, Tiranë)



Foto: F. Elezi (Valias, Tiranë)

Timusi

Thymus vulgaris L

Përhapja: Takohet në vendet e Mesdheut perëndimor e në Ballkan, pra dhe në vendin tone (Mirditë, Shkodër, Rubik, Kurbin etj). Kryesisht në vendet e kullotave barishtore të zonës së ulët si dhe në brezin e kullotave verore.

Përshkrimi: Është barishtore shumëvjeçare e dendur e me kërcej zvarritës; prej tij ngrihen kërcejtë lulore. Gjethet i ka të vogla, gjatoshë, gati pa bisht dhe e pikëzuar me gjëndra, pak a shumë pushlore e me buzë gati të përveshura. Lulet formojnë tufa cimash sqetullore në disa kate skajore; janë dybuzore të parregullta, me ngjyrë trëndafili rrallë të zbardhura.

Shtimi: Zakonisht në pranverë me anën e copave, megjithatë mund të bëhet dhe me farë.

Përdorimi: Droga përbëhet gati nga gjithë pjesa vegjetative në kohën e lulëzimit; gjethet kanë gjëndra dhe qime mbuluese. Bima ka aromë të fortë shpuese dhe shije aromatike. Timusi, një erëzë shumë e mirë, shërben edhe në aplikimet mjekësore. Ajo ka një veprim tonik të përgjithshëm, për të cilin rekomandohet në anemitë. Përdoret dhe si antispazmatik në kolla e në nxjerrjen e mukozave sekretore në bronkitet kronike, në katarret vaginale etj.



Foto: D. Xhulaj (Koplik, Malësi e Madhe)



Foto: D.Xhulaj (Valias, Tiranë)

Sanza

Gentiana lutea L

Përhapja: Është lloj i zonave malore, deri rreth 2000-2500 m, të Evropës qendrore e jugore deri në Azinë e vogël; edhe në Shqipëri është mjaft e përhapur sidomos në trevat veriore, por këto vitet e fundit është pakësuar shumë si rezultat i keq shfrytëzimit e vjeljes pa kriter.

Përshkrimi: Është një barishte shumëvjeçare, me kërcell të drejtë cilindrik. Gjethet e bazës i ka të mëdha, eliptike e të ngushtuara në bisht, me nervura të dalluara mirë paralele të harkuara; ato të kërcellit vijnë duke u ngushtuar e zgjatur drejt majës dhe bëhen të përkundërta. Lulet janë të dukshme, të verdha ari, të mbledhura në cima të ngjeshura në sjetullat e gjetheve, duke marrë pamjen e qerthujve lulorë; ato kanë një kurorë me 5-9 pjesë të zgjatura, me majë të mprehtë e të ngjitura në bazë, fryti është kapsollë vezake me majë të mprehtë që çahet në dysh.

Shtimi: Zakonisht kërkon tokë të drenazhuar, intensitet të lartë drite dhe në zona me temperaturë jo shumë të lartë. Shtohet me farë, zakonisht në periudhë pranvere të hershme, por dhe vonë në dimër.

Përdorimi: Droga mjekësore përbëhet nga rizoma e rrënjëve të bimëve të rritura, të grumbulluara në pranverë e në vjeshtë; këto të freskëta kanë ngjyrë gri në të verdhë, por kur thahen marrin ngjyrë të kuqe në kafe. Rrënjët e Sanëzës shërbejnë në trajtimet kundër anemisë. Stimulues në prodhimin e lëngut gastrik dhe të sekrecioneve intestinale. Sanëza është tonik i hidhur dhe përdoret në industri përgatitjen e pijeve tonike, nxitës i sekretimit të pështymës etj.



Foto: F. Elezi (Bogë, Shkrel)

Dëllinja e zezë

Juniperus communis L

Përhapja: Është bimë që preferon temperaturat e ulëta për tu zhvilluar. Gjendet ne Azi. Amerikën e veriut e në Europë, veçanërisht në pjesën malore të Mesdheut.

Përshkrimi: Është kaçube me lartësi 1 deri 2 m, shumë e degëzuar në bazë. Gjethet janë treshe, nga 1 deri në 2 cm të gjata, shumë të ngushta dhe me majë të mprehtë. Është specie dioike me lule mashkullore në formë fshese sferike dhe lule femërore me nga tri luspa të cilat pas pllenimit, lidhen e bëhen tulore në fazën e pjekjes. Fryti është kokërr që piqet vetëm pas 2 vjetësh.

Shtimi: Shtohet me anë të farës të marrë nga frutat e vitit paraardhës, të cilat zakonisht gjenden në pjesët e poshtme të bimës në krahasim me frutat e papjekura të vitit aktual. Mund të shtohet dhe në rrugë agamike, por është vështirë të bëhen prerje të rrënjëve.

Përdorimi: Droga përbëhet nga frytet e pjekura e të thara të shkurres së dëllinjës së zezë. Përdoret për trajtimin e sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes, ndihmon në lehtësimin e kollës, falë veprimit anti-septik dhe ekspektorant. Përdorim gjen dhe si diuretik dhe në çrregullimet e traktit tretës, në reumatizmin e kyçeve etj.



Foto: F.Elezi (Steblevë, Librazhd)



Foto: D. Xhulaj

Boronica

Vaccinium myrtillus L

Përhapja: Shkurre e përhapur në Evropë, Azi e Amerikën veriore. Në vendin tonë është mjaft e përhapur në trevat veriore (Kukës, Pukë, Tropojë), në pyje e kullota në lartësitë rreth 1000-1500 m.

Përshkrimi: Gjethet i ka vezake të zgjatura, të këmbyera, me ngjyrë të gjelbër të errët, ndërsa lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve. Ato janë me petla të ngjitura dhe me formë kampanë të vogël me pesë dhëmbë. Fryti është bakë gati sferike me ngjyrë blu, i ngrënshëm, i pasur me tanina. Boronica lulëzon në periudhën Maj-Qershor, ndërsa frutat piqen në fund të verës-fillimi i vjeshtës.

Shtimi: Me farë duke patur kujdes që të vilen frutat plotësisht të pjekur.

Përdorimi: Nga frytet përgatitet ekstrakti i thatë i tyre i pasur me antocianinë. Këto pigmente me cilësi vitaminike përdoren kundër çrregullimeve të enëve të gjakut.

Përdoret si adstringjent, dizifektues e diuretik. Gjen përdorim dhe si hipoglicemik. Ekstraktet e bimës kanë dhe veti antikërpudhore.



Foto: D. Xhulaj

Borziloku

Ocimum basilicum L

Përhapja: Borziloku rritet në mbarë Mesdheun dhe në Evropën e Jugut. Në Shqipëri takohet si në gjendje të egër por dhe të kultivuar (Koplik, Shijak, Lushnje, Berat etj).

Përshkrimi: Bimë barishtore njëvjeçare me rrënjë boshtore dhe kërcell katër këndor, të degëzuar, 20 deri 40 cm lartësi. Gjethet janë të përkundrejt, me bishta të shkurtër, të lëmuar, me formë shtizor në ovale, me llapën e gjethes të lëmuar ose me fryrje, me ngjyrë të gjelbër dhe vjollcë. Lulet të grupuara nga 6-10 qëndrojnë në lulëri në formë kalliri. Lulëzimi ndodh nga Qershori deri në Tetor.

Shtimi: Shtohet lehtësisht duke mbjellë farat tip akene në tokë, në farishte. Mb-jellja në fushë të hapur fillon në pranverë dhe mund të vazhdojë gjatë gjithë verës.

Përdorimi: Borziloku është një bimë popullore e Mesdheut që ka vlera ushqimore dhe mjekësore, të cilave i janë thurur lavde që në lashtësi. Ka një shije delikate e të ëmbël, madje dhe pak djegëse, por më të butë se rigoni. Bimë e kultivuar shumë aromatike, që përmban vaj esencial të pasur me shumë lëndë aktive. Infuzi i borzilokut ka veti antispazmatike, stomakike e karminative. Përdoret kundër diabetit, përmirësojnë funksionin e pankreasit në prodhimin efikas të insulinës. Kundër dhimbjeve të reumatizmës, artritit dhe osteoartritit. Është një detoksifikues natyral dhe ul nivelet e acidit urik në trup.



Foto: D.Xhulaj (Koplik, Malësi e Madhe

Përmbajtja

Dy fjale lexuesit.....	3-6
Perimet.....	7
Bishtajoret.....	57
Drithërat (grurë dhe thekër).....	66
Misri.....	69
Hardhia.....	81
Pemët frutore.....	91
Pemët subtropikale.....	106
Ulliri.....	124
Bimet mjekësore dhe aromatike.....	138-150
Përmbajtja e lëndës.....	151

CIP Katalogimi për botim BK Tiranë

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Katalogu i varieteteve të fermerit / Universiteti Bujqësor
i Tiranës. – Tiranë : JUPITER GROUP, 2018

152 f. : me il. ; 25x17 cm.

ISBN 978-9928-4525-0-4